

BYROJA KOSOVARE E SIGURIMIT - BKS
KOSOVSKI URED OSIGURANJA - KUO
KOSOVO INSURANCE BUREAU - KIB

Nr. 608/22 De: 05.07.22
PRISHTINË

BYROJA KOSOVARE E SIGURIMIT

PASQYRAT FINANCIARE

MË DHE PËR VITIN E PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2021

ME RAPORTIN E AUDITORIT TË PAVARUR

Përbajtja

	Faqe
Raporti i Auditorit të Pavarur	1-2
Pasqyra e të ardhurave gjithëpërfsirëse	3
Pasqyra e pozicionit financiar	4
Pasqyra e rrjedhës së parasë	5
Shënimet e pasqyrave financiare	6 - 28
Aneks – Raport auditimi aktuaristik	

Raporti i Auditorit të Pavarur

Grant Thornton LLC
Rexhep Mala 18
10000 Pristina
Kosovo
T +383 (0)38 247 801
F +383 (0)38 247 802
E Contact@ks.gt.com
VAT No. 330086000

Për Këshillin Administrativ të Byrosë Kosovare të Sigurimit

Opioni

Ne kemi audituar pasqyrat financiare shoqëruese të Byrosë Kosovare të Sigurimit ("Byroja" ose BKS), që përfshijnë pasqyrën e pozicionit finanziar më 31 Dhjetor 2021, pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse, pasqyrën e ndryshimeve në fonde dhe pasqyrën e rrjedhës së parasë për vitin që ka përfunduar në këtë datë, dhe shënimet tjera shpjeguese për pasqyrat financiare duke përfshirë një përbledhje të politikave të rëndësishme të kontabilitetit.

Sipas opinionit tonë pasqyrat financiare shoqëruese paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financier të Byrosë më 31 Dhjetor 2021, dhe performancën e saj financiare dhe rrjedhën e parasë për periudhën që ka përfunduar në këtë datë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

Baza për Opinion

Ne kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve pëershkruhen më tej në Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare në raportin tonë. Ne jemi të pavarur nga Byroja në përputhje me Bordin e Standardeve Ndërkombëtare të Etikës për Kodin e Etikës së Kontabilistikës për Kontabilistikë Profesionistë (Kodi BSNEK) së bashku me kërkesat etike që janë relevante për auditimin tonë të pasqyrave financiare në Kosovë, dhe ne kemi përbushur përgjegjësinë tonë etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidencat e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar një bazë për opinionin tonë.

Theksim i çështjes

Siç është shpalosur në shënimin 21 të pasqyrave financiare shoqëruese, më 31 dhjetor 2021, kërkesat nga paditë e ngritura kundër Byrosë nga kompanitë e sigurimit (Sigkos, Insig dhe Dukagjini) janë 1,739 mijë euro dhe pretendimet nga paditë e ngritura nga punonjësit dhe ish-punonjësit arrijnë në 1,055 mijë euro ose në total 2,794 mijë euro. Menaxhmenti i Byrosë analizon dhe vlerëson rregullisht rreziqet e humbjeve nga këto procese gjyqësore, në bazë të të cilave vlerëson se nuk do të rezultojnë në dalje materiale të konsiderueshme të mjeteve. Prandaj, asnjë provizion nuk është njojur në këto pasqyra financiare për humbjet e mundshme nga këto çështje gjyqësore dhe pretendime më dhe përvitin e përfunduar më 31 dhjetor 2021.

Opioni ynë nuk është modifikuar më tej në lidhje me çështjen e mësipërme.

Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe të atyre të ngarkuar me Qeverisjen për Pasqyrat Financiare

Menaxhmenti është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me SNRF-të, dhe për kontrollin e brendshëm që përcaktohet nga menaxhmenti e që është i nevojshëm për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare që të janë pa ndonjë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Gjatë përgatitjes së pasqyrave financiare, menaxhmenti është përgjegjës për vlerësimin e hipotezës së vijimësisë së Byrosë, shpalosjet, çështjet e ndërlidhura me vijimësinë dhe përdorimin e bazës së vijimësisë në kontabilitet përpos nëse Menaxhmenti dëshiron të likuidojë Byronë, ndërprenë operacionet ose nuk ka alternativë reale përpos ta bëjë këtë veprim.

Ata që janë të ngarkuar me qeverisjen janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Byrosë.

Përgjegjësia e Auditorit për auditimin e pasqyrave financiare

Objektivat tonë janë ofrimi i sigurisë së arsyeshme në lidhje me çështjen se a janë pasqyrat financiare të liruara nga gabimet materiale si rezultat i mashtimit apo gabimit dhe lëshimi i një raporti të auditorit që përbanë opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është nivel i lartë i sigurisë, por nuk është garacion se auditimi në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit do të zbulojnë gabimet materiale nëse ato egzistojnë. Gabimet mund të ndodhin nga mashtimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse individualisht apo në tërësi pritet që të ndikojnë vendimet ekonomike të përdoruesve që bazohen në në këto pasqyrat financiare.

Si pjesë e auditimit, në përputhje me SNA, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe mbajmë skepticizmin profesional gjatë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë riskun e gabimeve materiale në pasqyrat financiare që vijnë si rezultat i gabimit apo mashtimit, dizajnojmë dhe performojmë procedurat e auditimit në lidhje me ato risqe dhe mbajmë dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe e përshtatshme për të ofruar bazën për opinionin tonë. Risku i mosbulimit të gabimeve materiale nga mashtimet është më i lartë se sa ai i gabimit për shkak se rishku i mashtimit mund të përbajë marrëveshje të fshehta, falsifikime, lëshime të qëllimshme, keqinterpretime apo refuzime të kontrolleve të brendshme.
- Kuptojmë kontrollat e brendshme që janë relevante me auditimin në mënyrë që të dizajnojmë procedurat e auditimit që janë të përshtatshme me rrethanat, mirépo jo me qëllim për dhënien e një opinion mbi efektivitetin e kontrollave të brendshme të Byrosë.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të kontabilitetit të përdorura dhe arsyeshmërinë e kontabilitetit si dhe shpalosjet e bëra nga menaxhmenti.
- Nxjerrim përfundime në lidhje me përshtatshmërinë e përdorimit bazës së hipotezës së vijimësisë së kontabilitetit, duke u bazuar në evidencat e auditimit, nëse një pasiguri materiale ekziston në lidhje me ngjarjet ose kushtet që mund të shkaktojnë dyshim të lartë që Byroja mund të vazhdojë operimin. Nëse ne vijmë në përfundim se një pasiguri materiale ekziston, ne jemi të detyruar t'i kushtojmë vëmendje në reportin tonë të auditimit në shpalosjet e pasqyrave financiare ose nëse shpalosjet e tillë janë jo të përshtatshme, të modifikojmë opinionin tonë. Përfundimet tona janë të bazuara në evidencat tona të auditimit të siguruara deri në datën e raportit tonë. Megjithatë, ngjarjet apo kushtet e ardhshme mund të shkaktojnë që Byroja të pushojë së përbushuri hipotezën e vijimësisë.
- Vlerësimin e prezantimit, strukturës dhe përbajtes se përgjithshme të pasqyrave financiare duke përfshirë shpalosjet dhe nëse pasqyrat financiare prezantonjë transaksionet dhe ngjarjet themelore në mënyrë të drejtë.

Ne komunikojmë me ata që janë të angazhuar me qeverisjen e Byrosë Kosovare të Sigurimit, përpos çështjeve të tjera, për shtrirjen, kohëzgjatjen dhe gjetjet e auditimit duke përfshirë mangësitë e mëdha eventuale në kontrollot e brendshme që ne mund të idenfitikojmë gjatë auditimit tonë.

Grant Thornton LLC
Prishtinë,
1 korrik 2022

Marjan Andonov
Auditor ligjor



Byroja Kosovare e Sigurimit
Pasqyra e të ardhurave gjithëpërfshirëse
Për vitin që ka përfunduar më 31 dhjetor 2021

	Shënimë	Për vitin që ka përfunduar më 31 dhjetor 2021 (në 000 Euro)	Për vitin që ka përfunduar më 31 dhjetor 2020 (në 000 Euro)
Të hyrat			
Të hyrat nga primet e sigurimeve	6	8,578	4,972
Primet e ceduara për risigurues / primet e risigurimit	7	<u>(53)</u>	<u>(70)</u>
Primet e shkruara neto			
Ndryshimet në rezervat e primeve të pafitaura	19	<u>(161)</u>	<u>134</u>
Primi i fituar neto			
Të hyrat tjera	8	13,056	8,536
Të hyrat nga ndryshimet në të arkëtueshmet nga kompanitë e sigurimit për rezervat teknike	17,18	<u>(3,814)</u>	<u>964</u>
Gjithsej të hyrat			
Shpenzimet e humbjes dhe të rregullimit	18	<u>(6,606)</u>	<u>(7,206)</u>
Kostot e marrjes në sigurim	9	<u>(9,978)</u>	<u>(6,307)</u>
Shpenzimet administrative	10	<u>(1,022)</u>	<u>(1,023)</u>
Gjithsej humbja dhe shpenzimet			
(Teprica)/ Mungesa për vitin		<u>(17,606)</u>	<u>(14,536)</u>
Të hyrat tjera gjithëpërfshirëse		-	-
Gjithsej të ardhurat gjithëpërfshirëse			
		<u>-</u>	<u>-</u>

Shënimet shoqëruese nga 1 deri 23 janë pjesë përbërëse të këtyre pasqyrave financiare

**Byroja Kosovare e Sigurimit
Pasqyra e pozicionit finansiar
Për vitin që ka përfunduar më 31 dhjetor 2021**

	Shënimë	Më 31 dhjetor 2021 (në 000 Euro)	Më 31 dhjetor 2020 (në 000 Euro)
Pasuritë			
Paraja dhe ekuivalentët e parasë	11	3,116	1,831
Të arkëtueshmet	12	3,234	2,449
Prona, impiantet dhe pajiset tjera	13	81	56
Pasuria me të drejtë përdorimi	14	65	53
Pasuritë e paprekshme	15	27	31
Kosto e shtyrë e përvetësimit	16	-	60
Të arkëtueshmet nga kompanitë e sigurimit për rezerva teknike	17	14,225	18,039
Të arkëtueshmet nga kompanitë e sigurimit për INSIG		123	171
Gjithsej pasuritë		20,871	22,690
Detyrimet			
Detyrimet e sigurimit për humbjet dhe shpenzimet e rregullimit të humbjeve	18	14,225	18,039
Detyrimet e rezervës së dëmeve INSIG		123	171
Rezervat e primit të paftuar	19	574	413
Detyrimet e qirasë	14	65	43
Detyrime të tjera	20	5,884	4,024
Gjithsej detyrimet		20,871	22,690

Këto pasqyra financiare janë miratuar nga Këshilli Administrativ i Byrosë më 29 prill 2022 dhe nënshkruar në emër të tij nga:

Sami Mazreku
Sami Mazreku
Drejtëor Ekzekutiv



Valon Berisha
Valon Berisha
Drejtëor Financiar

Shënimet shoqëruarët nga 1 deri 23 janë pjesë përbërëse të këtyre pasqyrave financiare.

Byroja Kosovare e Sigurimit
Pasqyra e rrjedhës së parasë
Për vitin që ka përfunduar më 31 dhjetor 2021

	Shënimë	Për vitin që ka përfunduar më 31 dhjetor 2021 (në 000 Euro)	Për vitin që ka përfunduar Më 31 dhjetor 2020 (në 000 Euro)
Rrjedha e parasë nga aktivitetet operative			
Teprica/(Mungesa) për vitin		-	-
Rregullimet:			
Zhvlerësimi dhe amortizimi	13,14,15	84	88
Shpenzimet interesit për pasuritë e marra me qira	14	3	5
<i>Ndryshimet në pasuritë dhe detyrimet operative</i>			
Ndryshimi në të arkëtueshmet nga kompanitë e sigurimeve për rezerva teknike	17	3,814	(964)
Ndryshimi në kostot e shtyra të përvetësimit	16	60	(20)
Ndryshimi në të arkëtueshmet	12	(785)	(1,356)
Ndryshimi në rezervat e primit të pafituar	19	161	(134)
Ndryshimi në detyrimet e sigurimeve për humbjet dhe shpenzimet e rregullimit të humbjeve	18	(3,814)	964
Ndryshimet në llogarinë e ruajtjes	11	(1,300)	-
Ndryshimet në detyrime të tjera	14,20	1,882	1,292
Paraja neto e (përdorur)/gjeneruar në aktivitetet operative		105	(125)
Rrjedha e parasë nga aktivitetet investuese			
Blerja e pajisjeve, ROA dhe pasurive të patrupëzuara	13,15	(116)	(67)
Paraja neto e përdorur në aktivitetet investuese		(116)	(67)
Rrjedha e parasë nga aktivitetet financuese			
Pagesat e qirasë	14	(54)	(60)
Paraja neto e përdorur në aktivitetet financuese		(54)	(60)
Neto rritja në para dhe ekuivalentë të parasë			
Paraja dhe ekuivalentët e parasë më 1 janar		331	523
Paraja dhe ekuivalentët e parasë në fund të vitit	11	266	331

Shënimet shoqëruese nga 1 deri 23 janë pjesë përbërëse të këtyre pasqyrave financiare.

**Byroja Kosovare e Sigurimit
Shënimet mbi pasqyrat financiare
Për vitin që ka përfunduar më 31 dhjetor 2021**

1 TË PËRGJITHSHME

Në përputhje me Ligjin nr. 04/L-018 për Sigurimin e Detyrueshëm nga Auto përgjegjësia, Banka Qendrore e Republikës së Kosovës dhe të gjitha Kompanitë e Sigurimeve të Republikës së Kosovës kanë nënshkruar marrëveshjen për themelimin e Byrosë Kosovare të Sigurimeve ("BKS" apo "Byroja"). Në pajtim me Ligjin, BKS ka marrë përsipër të gjitha operacionet nga Shoqatat e Sigurimeve të Kosovës të mëparshme dhe Fondi i Garancisë nga 1 janar 2012, së bashku me të gjitha pasuritë dhe detyrimet e tyre.

Byroja është themeluar me qëllim për të siguruar përputhshmërinë me të gjitha detyrimet që rrjedhin nga sistemi Ndërkombëtar i kartës së Sigurimit.

Në veprimtarinë e saj Byroja:

- Përfaqëson anëtarët në marrëdhëniet me organizatat ndërkombëtare në fushën e Sigurimeve të Detyrueshme nga Auto përgjegjësia
- Mbledh dhe përpunon të dhëna statistikore lidhur me Sigurimin e Detyrueshëm nga Auto përgjegjësia
- Furnizon anëtarët me Çertifikata Ndërkombëtare të Sigurimit (Karton të Gjelbër) sipas formatit te përcaktuar nga Këshilli i Byrove,
- Siguron kryerjen e detyrave në lidhje me anëtarësimin e saj në Këshillin e Byrove
- Ratifikon marrëveshje me Byrotë homologe
- Kryen funksione të Byrosë trajtuese, paguese dhe të shërbimit në përputhje me dispozitat e Rregullores së Brendshme të Këshillit të Byrove dhe marrëveshjet suplementare;
- Bashkëpunon me organet shtetërore për çështjet që kanë të bëjnë me Sigurimin e Detyrueshëm nga Auto përgjegjësia,
- Administron Fondin Garantues të Kartonit të Gjelbër, Fondin e Kompensimit dhe Policën e Sigurimit Kufitar
- Menaxhon Fondin e Kompensimit me qëllim të pagesës së dëmeve në territorin e Republikës së Kosovës në raste si:
 - a) Dëmshpërblimi nga përdorimi i mjetit motorik të pasiguruar,
 - b) Dëmshpërblimi nga mjeti motorik i pasiguruar me regjistrim të huaj,
 - c) Dëmshpërblimi nga përdorimi i mjeteve të paidentikuara,
 - d) Dëmshpërblimi në rast të likuidimit apo falimentimit të siguruesit dhe
 - e) Dëmshpërblimi bazuar në sigurimin kufitar
- Siguruesit të cilët ushtrojnë veprimtari në sigurimin e detyrueshëm në territorin e Republikës së Kosovës, janë të detyruar të kontribuojnë finansiarisht në baza tremujore në fondin e kompensimit, në përpjesëtim të drejtë me primet e realizuara në këto lloj sigurimesh në tre mujorin paraardhës.

Policat e sigurimit shiten në çdo pikë kufitare në Kosovë. Të gjitha primet bruto të grumbulluara janë shpërndarë te të gjitha kompanitë e licencuara të sigurimit që veprojnë në Kosovë, pas mbulimit të shpenzimeve operative dhe pagesës së dëmeve të Byrosë. TVSH-ja dhe tatimi në premitë bruto të lëshuara është shpërndarë nga Byroja tek kompanitë e sigurimeve të cilët janë përfundimisht përgjegjëse për të paguar TVSH-në e llogaritur në 18%.

**Byroja Kosovare e Sigurimit
Shënimet mbi pasqyrat financiare
Për vitin që ka përfunduar më 31 dhjetor 2021**

2 POLITIKAT KONTABËL

Politikat kontabël kryesore të adaptuara në përgatitjen e këtyre pasqyrave financiare janë detajuar si më poshtë.

2.1 Bazat e përgatitjes

Këto pasqyra financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar dhe rregulloret e Bankës Qendrore të Kosovës të aplikueshme për kompanitë e sigurimit ("Rregullat e BQK-së").

Pasqyra financiare janë përgatitur më dhe përfunduara më 31 dhjetor 2021 dhe 2020. Të dhënat aktuale dhe krahasuese në këto pasqyra financiare janë të shprehura në mijëra Euro, përvèç nëse ceket ndryshe. Nëse është e nevojshme, shifrat krahasuese janë riklasifikuar në përputhje me ndryshimet e paraqitura për vitin aktual.

2.2 Adoptimi i standardeve të reja ose të rishikuara ndërkombëtare të raportimit financiar

2.2.1 Standardet dhe Interpretimet efektive në periudhën aktuale

Standardet dhe ndryshimet që janë efektive për herë të parë në vitin 2020 janë:

- Përkufizimi i një biznesi (Ndryshimet në SNRF 3)
- Përkufizimi i Materialit (Ndryshimet në SNK 1 dhe SNK 8)
- Reforma e Referencës së Normës së Interesit (Ndryshimet në SNRF 9, SNK 39 dhe SNRF 7)
- Ndryshimet në Referencat në Kornizën Konceptuale (Standarde të Ndryshme)
- COVID-19 Koncesione të Lidhura me Qira (Ndryshime në SNRF 16)

Miratimi i ndryshimeve të mësipërme nuk ka ndikim në këto pasqyra financiare

2.2.1 Standardet dhe interpretimet e lëshuara nga BSNK por ende jo efektive dhe jo të aplikuara më herët nga Byroja

Standardet dhe ndryshimet që nuk janë ende efektive dhe nuk janë miratuar herët nga Grupi përfshijnë:

- SNRF 17 Kontratat e Sigurimit
- Ndryshimet në SNRF 17 Kontratat e Sigurimit (Ndryshimet në SNRF 17 dhe SNRF 4)
- Referencat në Kornizën Konceptuale
- Të ardhurat para përdorimit të synuar (Ndryshimet në SNK 16)
- Kontrata të Rënda - Kostoja e Përbushjes së Kontratës (Ndryshimet në SNK 37)
- Përmirësimet Vjetore të Standardeve të SNRF-së Cikli 2018-2020 (Ndryshimet në SNRF 1, SNRF 9, SNRF 16, SNK 41)
- Klasifikimi i detyrimeve si aktuale apo jo-korente (Ndryshime në SNK 1)

Këto ndryshime nuk pritet të kenë një ndikim të rëndësishëm në pasqyra financiare në periudhën e aplikimit fillostar.

2.3 Valuta funksionale dhe ajo e prezantimit

Zërat e përfshirë në pasqyra financiare janë matur duke përdorur valutën e hapësirës primare ekonomike në të cilin operon Byroja ("valuta funksionale"). Këto pasqyra financiare janë të prezantuara në Euro, që është valuta funksionale dhe e prezantimit të Byrosë.

2.4 Transaksionet në valutë të huaj

Transaksionet e valutave të huaja përkthehen në valutën funksionale duke përdorur normat ekzistuese të këmbimit në datën e transaksioneve. Fitimet ose humbjet nga këmbimi që rezultojnë nga vendosja e transaksioneve të tillë dhe nga këmbimi i fund vitit të pasurive dhe detyrimeve monetare të nominuara në valuta të huaja njihen në fitim ose humbje.

2.5 Përdorimi i vlerësimeve dhe gjykimeve

Përgatitja e pasqyrave financiare kërkon nga menaxhmenti të bëj gjykime, vlerësime dhe supozime që ndikojnë në aplikimin e politikave dhe vlerave të raportuara të pasurive dhe detyrimeve, të hyrave dhe shpenzimeve (referohu në Shënimin 3).

Vlerësimet dhe supozimet e lidhura bazohen në eksperiencën historike dhe faktorë të tjerë të ndryshëm që besohet të jenë të arsyeshëm në rrethanat, rezultatet e të cilave formojnë bazën e gjykimeve për vlerat bartëse të pasurive dhe detyrimeve që nuk janë lehtë të dukshëm nga burimet tjera. Rezultatet aktuale mund të ndryshojnë nga vlerësimet.

Byroja Kosovare e Sigurimit
Shënimet mbi pasqyrat financiare
Për vitin që ka përfunduar më 31 dhjetor 2021

2 POLITIKAT KONTABËL (VAZHDIM)

Vlerësimet dhe supozimet themelore janë rishikuar në bazë të vazhdueshme. Rishikimet e vlerësimeve të kontabilitetit janë njojur në periudhën në të cilën janë rishikuar, nëse rishikimi ndikon vetëm në atë periudhë ose në periudhën e inspektimit dhe periudhat e ardhshme, nëse inspektimi ndikon periudhat e tanishme dhe të ardhshme.

2.6 Prona dhe pajisjet

Prona dhe pajisjet mbahen në koston historike minus zhvlerësimi i akumuluar. Kosto historike përfshinë të gjitha shpenzimet që i takojnë drejtë për së drejti blerjes së artikujve.

Kostot pasuese janë përfshirë në vlerat bartëse të pasurive ose njihen si pasuri e veçantë, sipas nevojës, vetëm kur është e mundur që benifitet e ardhshme ekonomike të lidhura me artikuj do të rrjedhin te Byroja dhe kur kostoja e artikullit mund të matet me besueshmëri. Të gjitha riparimet dhe mirëmbajtjet tjera ngarkohen në fitim ose humbje gjatë periudhës financiare në të cilën ato kanë ndodhur.

Zhvlerësimi i pronës dhe pajisjeve është llogaritur duke përdorur metodën drejtvizore për të alokuar kostot e tyre të vlerave të mbetur përgjatë jetëgjatësisë së vlerësuar, si në vazhdim:

Pajisjet	20%
Mobilet	20%
Automjetet	20%
Investimet në objektet e marra me qira	10%

Vlera e mbetur e pasurive rivlerësitet dhe korrigohen sipas nevojës, rregullohet në çdo datë të pasqyrës së pozicionit financier. Pasuritë që janë subjekt i zhvlerësimit rishikohen për dëmtimet kurdo që ngjarjet apo ndryshimet e rethanave tregojnë që vlera e bartur nuk është e rikuperueshme. Vlera e bartur e pasurive në të shlyhet menjëherë në vlerën e rikuperueshme nëse vlera e pasurisë është më e madhe sesa vlera e vlerësuar e rikuperueshme. Vlera e rikuperueshme është më e madhja e vlerës së drejtë të pasurisë minus kostot për të shitur dhe vlerës në përdorim. Fitimet dhe humbjet nga heqja prej përdorimit përcaktohen duke krahasuar të hyrat me vlerën e bartur. Këto përfshihen në fitim ose humbje.

2.7 Pasuritë me qira

Byroja si qiramarrës

Për çdo kontratë të re të lidhur në ose pas 1 janarit 2020, Byroja konsideron nëse një kontratë është, ose përban një qira. Një qira përcaktohet si 'një kontratë, ose pjesë e një kontrate, që përcjell të drejtën për të përdorur një pasuri (pasuri themelore) për një periudhë kohe në këmbim të vlerësimit'.

Në datën e fillimit të qirasë, Byroja njeri një pasuri me të drejtë përdorimi dhe një detyrim të qirasë në bilancin e gjendjes. Pasuria e të drejtës së përdorimit matet me kosto, i cili përbëhet nga matja fillestare e pasurisë së qirasë, çdo kosto fillestare direkte e shkaktuar nga Byroja, një vlerësim i çdo kostoje për të çmontuar dhe hequr pasurine në fund të qirasë, dhe çdo pagesë qiraje e bërë para datës së fillimit të qirasë (neto nga çdo stimulim i marrë).

Byroja zhvlerëson pasuritë me të drejtë përdorimi mbi një bazë lineare nga data me e hershme e fillimit të qirasë në fund të jetës së dobishme të pasurise me të drejtë përdorimi ose në fund të afatit të qirasë. Byroja gjithashtu vlerëson të drejtën e përdorimit të pasurise për zhvlerësim kur ekzistojnë tregues të tillë.

Në datën e fillimit, Byroja mat detyrimin e qirasë në vlerën aktuale të pagesave të qirasë të papaguara në atë datë, duke zbritur normën e interesit të nënkuptuar në qira nëse kjo normë është e disponueshme ose norma shtesë e huamarjes së Byrosë.

Pagesat e qirasë të përfshira në matjen e detyrimit të qirasë përbëhen nga pagesa fiksë (përfshirë në substancë fiksë), pagesa të ndryshueshme bazuar në një indeks ose normë, shuma që pritet të paguhën nën një garanci të vlerës së mbetur dhe pagesa që vijnë nga opzionet e arsyeshme të caktuara për të ushqrohen.

Pas matjes fillestare, detyrimi do të zgjedhur për pagesat e bëra dhe do të rritet për interesin. Ri-matet për të pasqyruar çdo rivlerësim ose modifikim, ose nëse ka ndryshime në pagesa fiksë në substancë.

Kur detyrimi i qirasë është rimatur, rregullimi përkatës pasqyrohet në pasurine e së drejtës së përdorimit, ose fitimin dhe humbjen nëse pasuria me të drejtë përdorimi është reduktuar tashmë në zero.

Byroja ka zgjedhur të japë llogari për qira afatshkurtra dhe qira të aseteve me vlerë të ulët duke përdorur mjetet praktike. Nëse ka ndonjë. Në vend që të njojin një pasuri të së drejtës së përdorimit dhe detyrimin e qirasë, pagesat në lidhje me këto njihen si një shpenzim në fitim ose humbje mbi një bazë lineare gjatë afatit të qirasë.

2.8 Pasuritë e paprekshme

Softueri kompjuterik

Kostot që lidhen drejtpërdrejt me produkte softuerike të identifikueshme dhe unike të kontrolluara nga Byroja që ndoshta do të gjenerojnë përfitime ekonomike dhe që tejkalojnë shpenzimet përtetë një vit, njihen si pasuri jo-materiale (patrupëzuara). Kostot e zhvillimit të softuerit kompjuterik janë njojur si pasuri dhe janë amortizuar duke përdorur metodën lineare gjatë një periudhe prej pesë vjetësh. Shpenzimet që lidhen me mirëmbajtjen e programeve kompjuterike njihen si shpenzime kur ato ndodhin.

Byroja Kosovare e Sigurimit
Shënimet mbi pasqyrat financiare
Për vitin që ka përfunduar më 31 dhjetor 2021

2 POLITIKAT KONTABËL (VAZHDIM)

2.9 Instrumentet Financiare

Njohja dhe ç'regjistrimi

Pasuritë financiare dhe detyrimet financiare njihen kur Byroja bëhet palë në provisionet kontraktuale të instrumentit finanziar. Pausuritë financiare ç'regjistrohen kur skadojnë të drejtat kontraktuale të rrjedhje të parasë nga pasuritë financiare, ose kur pasuritë financiare dhe kryesisht të gjitha risqet dhe përfitimet transferohen. Një detyrimi financiar ç'regjistrohet kur shuhet, shlyhet, anulohet ose skadon.

Klasifikimi dhe matja fillestare e pasurive financiare

Me përjashtim të atyre të arkëtueshmeve tregtare që nuk përbajnë një komponentë të rëndësishëm financimi dhe maten me çmimin e transaksionit në përputhje me SNRF 15, të gjitha pasuritë financiare fillimisht maten me vlerën e drejtë të regjulluar për kostot e transaksionit (kur është e zbatueshme).

Pasuritë financiare, përvèç atyre të përcaktuara dhe efektive si instrumente mbrojtëse, klasifikohen në kategoritë e mëposhtme:

- kostoja e amortizuar
- vlera e drejtë përmes fitimit ose humbjes (FVTPL)
- vlera e drejtë përmes të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse (FVOCI).

Në periudhat e paraqitura, Byroja nuk ka ndonjë pasuri financiare të kategorizuar si FVTPL dhe FVOCI. Klasifikimi përcaktohet nga të dy:

- modeli i biznesit të njësisë ekonomike për menaxhimin e pasurisë financiare
- karakteristikat kontraktuale të fluksit të parasë së pasurisë financiare.

Të gjitha të ardhurat dhe shpenzimet në lidhje me Pasuritë financiare që njihen në fitim ose humbje paraqiten brenda kostove të financës, të ardhurave të financave ose zërave të tjerë financiarë, me përjashtim të zhvlerësimit të të arkëtueshmeve tregtare që paraqitet brenda shpenzimeve të tjera.

Matja pasuese e pasurive financiare

Pasuritë financiare me kosto të amortizuar

Pasuritë financiare maten me koston e amortizuar nëse pasuritë plotësojnë kushtet e mëposhtme (dhe nuk janë përcaktuari si FVTPL):

- ato mbahen brenda një modeli biznesi qëllimi i të cilit është mbajtja e pasurive financiare dhe mbledhja e rrjedhjeve të parasë kontraktuale
- kushtet kontraktuale të pasurive financiare krijojnë rrjedhje të parasë që janë vetëm pagesa të kryegjësë dhe interesit mbi shumën e principalit të papaguar.

Pas njohjes fillestare, këto maten me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv. Zbritja hiqet kur efekti i zbritjes është i parëndësishëm. Paraja dhe ekuivalentët e parasë, tregtia dhe shuma e arkëtueshme të tjera hyjnë në këtë kategori të instrumenteve financiare.

Pasuritë financiare me vlerë të drejtë përmes fitimit ose humbjes (FVTPL)

Pasuritë financiare që mbahen brenda një modeli tjetër biznesi përvèç 'mbajnë për të mbledhur' ose 'mbajnë për të mbledhur dhe shitur' kategorizohen në vlerën e drejtë përmes fitimit dhe humbjes. Për më tepër, pavarësisht nga modeli

i biznesit Pasuritë financiare fluksset kontraktuale të parave të të cilave nuk janë vetëm pagesa të kryegjësë dhe interesit llogariten në FVTPL.

Pasuritë në këtë kategori maten me vlerën e drejtë me fitimet ose humbjet e njohura në fitim ose humbje. Vlerat e drejta e pasurive financiare në këtë kategori përcaktohet duke iu referuar pasurive te transaksioneve të tregut ose duke përdorur një teknikë vlerësimi atje ku nuk ekziston ndonjë treg aktiv.

Pasuritë financiare me vlerë të drejtë përmes të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse (FVOCI)

Kompania llogarit për pasuritë financiare në FVOCI nëse pasuritë plotësojnë kushtet e mëposhtme:

- ato mbahen nën një model biznesi qëllimi i të cilit është "të mbajë për të mbledhur" fluksset monetare shoqëruese dhe të shesë dhe
- kushtet kontraktuale të pasurise financiare krijojnë fluks monetare që janë vetëm pagesa të kryegjësë dhe interesit mbi shumën e principalit të papaguar.

Çdo fitim ose humbje e njohur në të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse (OCI) do të riciklohet me mosnjohjen e pasurisë.

**Byroja Kosovare e Sigurimit
Shënimet mbi pasqyrat financiare
Për vitin që ka përfunduar më 31 dhjetor 2021**

2 POLITIKAT KONTABËL (VAZHDIM)

2.10 Humbjet nga zhvlerësimi

Zhvlerësimi i pasurisë financiare

Kërkosat për zhvlerësim të SNRF 9 përdorin më shumë informacione që shohin përpara përfundimit të njohurumbjet e pritura kreditore - modelin e humbjes së pritur kreditor (ECL). Kjo zëvendëson AS modelin e humbjeve të ndodhura të SNK 39. Instrumentet brenda fushës së kërkosave të reja përfshinin hua dhe pasuritë të tjera financiare të tipit të borxhit të matura me kosto të amortizuar dhe FVOCI, të arkëtueshme tregtare, Pasuritë e kontratës të njohura dhe te matura sipas SNRF 15 dhe zotimet e huasë dhe disa kontrata të garancisë financiare (për lëshuesin) që janë nuk matet me vlerën e drejtë përmes fitimit ose humbjes.

Njohja e humbjeve kreditore nuk varet më nga identifikimi i parë i Kompanisë përfundimit të zhvlerësimit. Në vend të kësaj, Kompania konsideron një gamë më të gjërë informacione kur vlerëson rishkrime kreditore dhe matjen e humbjeve të pritshme kreditore, duke përfshirë ngjarjet e kaluara, kushtet aktuale, parashikime të arsyeshme dhe të mbështetura që ndikojnë në mbledhjen e pritshme të rrjedhjeve të parasë. Në zbatimin e kësaj qasjeje largpamëse, bëhet një dallim ndërmjet:

- instrumentet financiare që nuk janë përkeqësuar ndjeshëm në cilësinë kreditore që nga njohja fillestare ose që kanë risk kreditor të ulët ('Faza 1') dhe
 - instrumentet financiare që janë përkeqësuar ndjeshëm në cilësinë kreditore që nga njohja fillestare dhe risku kreditor i të cilëve nuk është i ulët ('Faza 2').
- 'Faza 3' do të mbulonte pasuritë financiare që kanë dëshmi objektive të zhvlerësimit në datën e raportimit. Humbjet e pritshme kreditore '12 - mujore ' njihen përfundimit të kreditit të jetës 'njihen përfundimit të kategorinë e dytë.

Matja e humbjeve të pritshme kreditore përcaktohet nga një vlerësim i ponderuar i probabilitetit të humbjeve kreditore gjatë jetës së pritur të instrumentit financiar.

Evidencia objektive që një pasuri financiare ose një grup pasurishë është i zhvlerësuar përfshin të dhëna të vëzhgueshme që vijnë në vëmendjen e Byrosë përfundimit e mëposhtme:

- a) Një vështirësi të konsiderueshme financiare të emetuesit ose debitorit;
- b) Një shkelje e kontratës, të tillë si një mospagim ose vonesë në pagesa;
- c) Bëhet e mundur që lëshuesi ose debitori të hyjë në falimentim ose riorganizim tjetër financiar;
- d) Zhdukja e një tregu aktiv përfundimtar përfshirë shakat e vështirësive financiare; ose
- e) Të dhëna të vëzhgueshme që tregojnë se ka një rënie të matshme në rrjedhën e parashikuar të ardhshëm të parave nga një grup pasurishë financiare që nga njohja fillestare e këtyre pasurive, megjithëse ulja ende nuk mund të identifikohet me pasuritë financiare individuale në Byronë, duke përfshirë:
 - Ndryshimet e pafavorishme në statusin e pagesës së emetuesve ose debitorëve në grup; ose
 - Kushtet ekonomike kombëtare ose lokale që ndërlidhen me mospagimin e pasurive në grup.

Byroja së pari vlerëson nëse provat objektive të zhvlerësimit ekzistojnë individualisht përfundimit të pasuritë financiare që janë individualisht të rëndësishme. Nëse Byroja përcakton se nuk ekziston asnjë provë objektive e zhvlerësimit përfundimit të një pasurie financiare të vlerësuar individualisht, qoftë i rëndësishëm apo jo, ai përfshin pasurine në një grup financiar me karakteristika të ngjashme të risikut kreditor dhe i vlerëson ato në mënyrë kolektive të zhvlerësimit. Pasuritë që vlerësohen individualisht përfundimit të zhvlerësimit dhe përfundimit të cilat një humbje nga zhvlerësimi njihet ose vazhdon të njihet nuk përfshihen në një vlerësim kolektiv të zhvlerësimit. Nëse ka prova objektive që një humbje nga zhvlerësimi është shkaktuar në hua dhe të arkëtueshme ose investime të mbajtura deri në maturim të bartura me kosto të amortizuar, shuma e humbjes matet si diferenca midis vlerës kontabël të pasurise dhe vlerës aktuale të zhvlerësimit të ardhshëm rrjedhjës së parave (duke përfshirë humbjet e ardhshme të kreditore që janë shkaktuar) zbritur me normën origjinale efektive të interesit të pasurisë financiare. Vlera kontabël e pasurisë zgjedhur përmes përdorimit të një llogaritës së lejimit dhe shuma e humbjes njihet në fitim ose humbje.

Nëse një investim i mbajtur deri në maturim ose një kredi ka një normë interesit të ndryshueshme, norma e skontimit përfundimit të matjen e çdo humbjeje nga zhvlerësimi është norma aktuale e interesit efektive përcaktaur me kontratë. Si një mjet praktik, Byroja mund të masë zhvlerësimin në bazë të vlerës së drejtë të një instrumentit duke përdorur një çmim tregu të vëzhguar.

Përfundimit të zhvlerësimit, pasuritë financiare grupohen në bazë të karakteristikave të ngjashme të risikut kreditor (në bazë të procesit të zhvlerësimit të Byrosë që konsideron llojin e pasurisë, industrinë, vendndodhjen gjeografike, statusin e vonesës dhe faktorët tjerë të rëndësishëm). Këto karakteristika janë të rëndësishme përfundimit të zhvlerësimit e rrjedhjeve të ardhshme të parave përfundimit të pasurive të tillë duke qenë tregues i aftësisë së emetuesit përfundimit të paguar të gjitha shumat e duhura sipas kushteve kontraktuale të instrumentit të zhvlerësimit.

Nëse në një periudhë pasuese, shuma e humbjes së zhvlerësimit zgjedhur dhe rënia mund të lidhet objektivisht me një ngjarje që ndodhet pasi u njoh zhvlerësimi (siç është zhvlerësimi i përmirësuar i kreditore), humbja e zhvlerësimit e njohur më parë kthehet duke rregulluar llogarinë e lejimit. Shuma e kthimit njihet në fitim ose humbje.

**Byroja Kosovare e Sigurimit
Shënimet mbi pasqyrat financiare
Për vitin që ka përfunduar më 31 dhjetor 2021**

2 POLITIKAT KONTABËL (VAZHDIM)

2.11 Humbjet nga dëmtimet

Pasuritë financiare të bartura në vlerën reale

Byroja vlerëson në secilën datë të pasqyrës së pozitës financiare nëse ka dëshmi objektive se një pasuri financiare e gatshme për shitje është dëmtuar, duke përfshirë edhe rastin e investimeve të ekuitetit të klasifikuara si të gatshme për shitje, një ulje e rëndësishme apo e tej zgjatur e vlerës reale të letrës me vlerë nën kosto të saj. Nëse një dëshmi e tillë ekziston për pasuritë financiare të gatshme për shitje, humbja kumulative e matur si diferençë ndërmjet kostos së përvetësimit dhe vlerës reale aktuale, minus ndonjë humbje e dëmtimit mbi pasurinë financiare të njohur më parë në fitim apo humbje është hequr nga ekuiteti dhe është njohur në pasqyrën e të ardhurave. Humbjet e dëmtimit të njohura në pasqyrën e të ardhurave në instrumentet e ekuitetit nuk janë kthyer më pas. Humbja e dëmit është kthyer përmes pasqyrës së të ardhurave, nëse në një periudhë pasuese vlerë reale e një instrumenti të borxhit të klasifikuar si i gatshëm për shitje rritet dhe rritja mund të lidhet në mënyrë objektive me ngjarjen që ndodh pasi që humbja e dëmtimit është njohur në fitim ose humbje.

Dëmtimi i pasurive të paprekshme

Pasuritë e paprekshme që kanë një kohë të pa definuar të përdorimit, nuk janë subjekte të amortizimit dhe testohen çdo vit për dëmtim. Pasuritë që janë subjekt i amortizimit rishikohen për dëmtim kurdo që ngjarjet ose ndryshimet në rrethana tregojnë se vlera bartëse mund të mos rikuperohet. Një humbje e dëmtimit njihet për shumën me të cilën vlera bartëse e pasurisë tejkalon shumën e rikuperueshme të saj. Vlera e rikuperimit është më e larta e vlerës bartëse të pasurive minus kostot për shitje dhe vlerës në përdorim. Për qëllimet e vlerësimit të dëmtimit, pasuritë grupohen në nivelet më të ulëta për të cilat ka rrjedha të parasë që janë të identifikuveshme veçmas (njësítë e gjenerimit të parasë).

2.12 Njohja e të ardhurave

Kontratat e përgjithshme të sigurimit

Të pagueshmet e sigurimit illogariten veçmas për të gjitha produktet e sigurimit dhe përbëhen nga primi kontingjent (pafituar), risku kontingjent (i pa skaduar) dhe humbja kontingjente (të papaguara në datën e mbylljes së vitit financiar). Të pagueshmet e sigurimeve (provizionet) paraqesin vlerësimet e pagesave në të ardhmen për dëmet e raportuara dhe të pa raportuara. Byroja nuk zbret të pagueshmet e sigurimeve. Çdo ndryshim në vlerësimet pasqyrohet në rezultatet e operacioneve në periudhën në të cilën vlerësimet janë ndryshuar. Vlerësimi i të pagueshmeve të sigurimit është një proces kompleks që ka të bëjë me pasiguri, që kërkon përdorimin e vlerësimet e gjykimeve të informuara.

Të hyrat

Bruto primet e shkruara regjistrohen në pranimin e pagesave të primit dhe janë transferuar në fitim në bazë prorata për një afat të mbulimit të policës. Bruto primet e shkruara reflektojnë shkrimet e biznesit gjatë vitit. Primet fitohen nga data e lidhjes së rrezikut, gjatë periudhës së dëmshpërblimit, bazuar në modelin e rreziqeve të lëshuara.

Primet e pafitaura

Provizoni për primet e pafitaura përbën proporcionin e bruto primit të shkruar që vlerësohet të fitohet në vitet financiare pasuese, kalkuluar veçmas për secilën kontratë duke përdorur metodën pro-rata-ditore, të përmirësuar nëse e nevojshme për të reflektuar ndonjë variacion në rreziqet e incidenteve gjatë periudhës të mbuluar me kontratë.

Rezerva për primin e pafituar përfshin primet e pranuara për rreziqet që nuk kanë skaduar ende. Në përgjithësi rezerva është lëshuar gjatë kohëzgjatjes së kontratës dhe është e njohur si të ardhura nga primi.

2.13 Klasifikimi i Produktave

Kontratat e sigurimit janë ato kontrata kur Byroja (siguruesi) ka pranuar risk të rëndësishëm të sigurimit nga pala tjetër (i siguruar) duke u dakorduar të kompensoj police mbajtësit nëse një ngjarje e specifikuar e pasigurt (ngjarje e siguruar) ka ndikim të kundër në siguruesin. Si direktivë e përgjithshme, Byroja përcakton nëse ka risk të rëndësishëm të sigurimit, duke krahasuar përfitimet e paguara me përfitimet e pagueshme nëse ngjarje e siguruar nuk ka ndodhur. Kontratat e sigurimit gjithashtu mund të transferojnë risk financiar.

Pasi që kontrata është kualifikuar si kontratë e sigurimit, ajo mbetet një kontratë e sigurimit për pjesën tjetër të jetës, edhe nëse riziku i sigurimit zvogëlohet në mënyrë të konsiderueshme gjatë kësaj periudhe, vetëm nëse të gjitha të drejtat dhe obligimet janë shuar.

2.14 Detyrimet e kontratave të sigurimit dhe kosto e shtyrë e përvetësimit

Dëmet (regullimet e humbjeve)

Dëmet e ndodhura përbëhen nga kostot e shlyerjes dhe trajtimin e dëmeve të paguara dhe të papuguar që rrjedhin nga ngjarjet që ndodhin gjatë vitit financiar së bashku me rregullimet e provizionimit të dëmeve të viteve paraprake. Dëmet pezull përbëjnë provizionimin për vlerësimin e Byrosë së kostos përfundimtare të zgjidhjes së të gjitha dëmet e ndodhura por të paguara në datën e raportimit të Pozicionit finansiar nëse janë raportuar apo jo, dhe shpenzimeve të trajtimit të dëmeve që lidhen me rregullimet të brendshme dhe të jashtme dhe një diferençë e kujdesshme. Dëmet e paguara janë vlerësuar nga shqyrtimi i ankesave individuale dhe duke e bërë lejim për dëmet e shkaktuara, por nuk janë raportuar ende, efekti i ngjarjeve të të dyjave të brendshme dhe të jashtme të parashikueshme, të tila si ndryshimet në procedurat e trajtimit të ankesave, inflacion, trendët gjyqësore, ndryshime legislative dhe përvojën e kaluar dhe trendet.

**Byroja Kosovare e Sigurimit
Shënimet mbi pasqyrat financiare
Për vitin që ka përfunduar më 31 dhjetor 2021**

2 POLITIKAT KONTABËL (VAZHDIM)

2.14 Detyrimet e kontratave të sigurimit dhe kosto e shtyrë e përvetësimit (vazhdim)

Provizonet për dëmet e pazgjidhura nuk janë zbritur. Rregullimet për provisionimet e dëmeve të përcaktuara në vitet e mëparshme janë të reflektuara në pasqyrat financiare të periudhës në të cilën janë bërë rregullime dhe të shpalosen veçmas nëse janë materiale.

Përderisa Këshilli Administrativ konstaton se detyrimet e sigurimeve për dëmet dhe rikuperimet e lidhura me risigurimin janë deklaruar në mënyrë të drejtë, përgjegjësia përfundimtare mund të ndryshojë si pasojë e informacionit të mëvonshëm dhe ngjarjet dhe mund të rezultojë në rregullime të rëndësishme në shumat e ofruara. Përshtatjet në shumat e pasiveve të sigurimit janë reflektuar në pasqyrat financiare për periudhën në të cilën janë bërë.

Kontingjentet për dëmet në proces gjyqësor

Një pjesë e dëmeve janë në proces gjyqësor, dhe për të cilat Byroja ka regjistruar detyrime të përshtatshme të sigurimit.

Risigurimi

Byroja lëshon primet e sigurimit dhe riskut në rrjedhë normale të biznesit, në mënyrë që të kufizoj humbjet e mundshme. Risigurimi regjistrohet bruto në Pasqyrën e pozicionit financiar. Pasuritë e risigurimit përfshijnë balancat e detyrimeve nga kompanitë e risigurimit në të dyja në humbjet e paguara dhe të papaguara si dhe në shpenzimet e rregullimeve të humbjes, por nuk përfshijnë lëshimin e primeve të paftitura. Byroja llogarit primet e lëshuara bazuar në bruto primet e shkruara dhe shpenzon primet që rezultojnë menjëherë. Asnjë pasuri i risigurimit nuk regjistrohet për primet e lëshuara të paftitura. Shumat e rikuperueshme nga risigurimet vlerësohen në mënyrë të qëndrueshme me detyrimin e dëmeve të lidhura me politikat e risigurimit.

Kostot e shtyra të përvetësimit

Kostot e përvetësimit përcaktohen si kosto që rrjedhin nga përvetësimi i kontratave të sigurimit të tillë si komisionet e agjentëve, printimi i policave dhe tatimi i primit.

Përvetësimet direkte janë shtyrë sipas kushteve të policave në fuqi një metodë në përputhje me llogaritjen e provisioneve të primeve të paftitura. Kostot e shtyra të përvetësimit prezantohen si pasuri të ndara në Pasqyrën e pozicionit financiar.

2.15 Paraja e gatshme dhe ekuivalentet e parasë

Për qëllime të pasqyrës së rrjedhës së parasë paraja dhe ekuivalentet të parasë përfshijnë llogaritë bankare që janë të liruara nga interes. Paraja dhe ekuivalentet e parasë janë mbahen me kosto të amortizuar në pasqyrën e pozicionit financiar.

2.16 Tatimi

Byroja transferon tek kompanitë e sigurimit primet e shkruara bruto dhe kompanitë e sigurimit paguajnë tatim prej 5% në prime bruto dhe gjithashtu edhe TVSH. Primet qe janë kthyer dhe rregullimet retroaktive të primit janë zbritur nga primet bruto për të arritur tek baza e tatimit.

Byroja i nënshtrohet tatimit mbi të ardhurat personale dhe kontributete të sigurimit social.

2.17 Përfitimet e punëtorëve

Kontributet e detyruara të sigurimit social

Byroja nuk bën asnjë provizionim dhe nuk ka obligim për pensionet e punonjësve mbi dhe për kontributet e paguara në planin pensional shtetëror, Fondi i Kursimeve Pensionale të Kosovës (FKPK).

2.18 Provizonet

Një provizion njihet kur Byroja ka obligim aktual si rezultat i një ngjarje në të kaluarën dhe është e mundur një rrjedhje e burimeve që përfaqësojnë përfitime ekonomike të cilat do të kërkohen për të shlyer obligimin, dhe një vlerësim i besueshëm mund të bëhet për shumën e obligimit. Provizonet janë rishikuar në secilën datë të pasqyrës së pozicionit financiar dhe janë rregulluar për të reflektuar vlerësim më të mirë aktual. Aty ku efekti i vlerës në kohë të parasë është material, shuma e provisionit është vlera aktuale e shpenzimit që pritet të kërkohet për të shlyer obligimin. Provizonet nuk janë njohur për humbje operative të së ardhmes.

2.19 Njohja e shpenzimeve

Shpenzimet operative janë njohur në pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse në bazë të përdorimit të shërbimit, kur kanë ndodhur.

2.20 Zotimet dhe kontingjencat

Detyrimet e kushtëzuara nuk nijhen në pasqyrat financiare. Ato shpalosen përpos nëse mundësia e rrjedhjes së burimeve që përfshijnë përfitime ekonomike është e largët. Një pasuri e kushtëzuar nuk nijhet në pasqyrat financiare por, shpaloset kur është e mundshme një rrjedhë e fitimeve ekonomike.

Shuma e humbjes nga kushtëzimet nijhet si provizion nëse është e mundur që ngjarjet në të ardhmen do ta konfirmojnë atë, një detyrim i shkaktuar në datën e Pasqyrës së pozicionit financiar dhe një vlerësim i arsyeshëm i shumës së humbjes të rezultuar mund të bëhet.

**Byroja Kosovare e Sigurimit
Shënimet mbi pasqyrat financiare
Për vitin që ka përfunduar më 31 dhjetor 2021**

2 POLITIKAT KONTABËL (VAZHDIM)

2.21 Transaksionet me palët e ndërlidhura

Palët e ndërlidhura përbëhen nga drejtoret e Byrosë, së bashku me entitetet të cilat ata i kontrollojnë, që mund të kenë ndikim të rëndësishëm mbi operacionet dhe menaxhmentin e Byrosë. Duke pasur parasysh se cilën marrëdhënie të mundshme me palët e ndërlidhura, vëmendja është e drejtuar më përbërjen e marrëdhënieve, dhe jo thjesht në formën ligjore.

2.22 Ngjarjet pas datës raportuese

Ngjarjet pas datës raportuese që sigurojnë informata shtesë në lidhje me pozicionin e Byrosë në datën e Pasqyrës së pozicionit financier (ngjarjet rregulluese), janë reflektuar në pasqyrat financiare. Ngjarjet pas datës së bilancit që nuk janë ngjarje rregulluese janë shpalosur në shënimet shpjeguese kur ato janë materiale.

**Byroja Kosovare e Sigurimit
Shënimet mbi pasqyrat financiare
Për vitin që ka përfunduar më 31 dhjetor 2021**

3 SUPOZIME DHE VLERËSIME TË RËNDËSISHME KONTABËL

Në aplikimin e politikave të kontabilitetit të Byrosë, nga menaxhmenti kërkohet të bëjë gjykime, vlerësimet dhe supozimet mbi vlerat bartëse të pasurive dhe detyrimeve që nuk janë lehtë të dukshme nga burimet tjera. Vlerësimet dhe supozimet e ndërlidhura janë bazuar në përvojën historike dhe faktorë të tjerë që janë konsideruar të janë relevantë. Rezultatet e vërteta mund të ndryshojnë nga këto vlerësimet.

Vlerësimi i detyrimeve të kontratës së sigurimit

Për kontratat e sigurimit jo-jetë, vlerësimet duhet të bëhen si përkostot e pritura përfundimtare të dëmeve të raportuara në datën e pasqyrës së gjendjes financiare ashtu edhe përkostot e pritura përfundimtare të dëmeve të pësuara por ende të pa raportuara në datën e pasqyrës së gjendjes financiare (IBNR). Kostoja përfundimtare e dëmeve të papaguara është vlerësuar duke përdorur një gamë të teknikave standarde aktuale të projekzionit të dëmeve.

Supozimi kryesor nën këto teknika është që përvoja e zhvillimit të dëmeve në të kaluar e Byrosë mund të përdoret për të projektuar zhvillimin e dëmeve në të ardhmen dhe kështu kostot përfundimtare të dëmeve. Si të tilla, këto metoda hulumtojnë zhvillimin e humbjeve të paguara dhe të pësuara, kostot mesatare për dëm dhe numrin e dëmeve të bazuar në zhvillimet e vëzhguar të viteve të mëhershme dhe shkallët e pritura të humbjes. Historiku i zhvillimit të dëmeve është kryesisht i analizuar nga vitet rastësore, por mund të analizohet më tej me anë të hapësirave gjeografike, si edhe nga linjat e rëndësishme të biznesit dhe llojet e dëmeve. Gjykimi shtesë kualitativ është përdorur për të vlerësuar se deri ku trendet e kaluara nuk mund të aplikohen për të ardhmen, në mënyrë që të arrihet në kostot përfundimtare të vlerësuar të dëmeve që paraqesin rezultatin e mundshëm nga një seri rezultatesh të mundshme, duke marrë në konsideratë të gjitha pasiguritë e përfshira.

Humbjet nga dëmtimi në të arkëtueshmet

Byroja rishikon të arkëtueshmet e saj të sigurimit dhe jo-sigurimit për të vlerësuar dëmtimin në bazë vjetore. Në përcaktimin nëse një humbje nga zhvlerësim duhet të regjistrohet në fitim ose humbje, Byroja bën gjykime nëse ka ndonjë të dhënë te mbikëqyrur që tregojnë se ka një rënje të matshme në flukset monetare të ardhshme të vlerësuara nga një debitor individual. Kjo evidencë mund të përfshijë të dhëna që tregojnë se ka pasur një ndryshim negativ në statusin e pagesave të debitorit.

**Byroja Kosovare e Sigurimit
Shënimet mbi pasqyrat financiare
Për vitin që ka përfunduar më 31 dhjetor 2021**

4 MENAXHIMI I RISKUT

Korniza qeverisëse

Objektivi kryesore i kuadrit të Byrosë mbi menaxhimin e riskut dhe atë finansiar është që të mbrojë Byronë nga ngjarjet që pengojnë arrijet e qëndrueshme të objektivave të performancës financiare, përfshirë dështimin e shfrytëzimit të mundësive. Menaxhmenti kyç njeh rëndësinë kritike të të pasurit një sistem të menaxhimit efikas dhe efektiv të riskut.

Këshilli Administrativ aprovon politikat e menaxhimit të riskut të Byrosë dhe takohet rregullisht për të aprovaruar ndonjë kërkesë komerciale, rregullative apo organizative të këtyre politikave. Këto politika përcaktojnë identifikimin e riskut të Byrosë dhe interpretimin e tij, limitojnë strukturën që të sigurojnë kualitetin e duhur dhe shpërndarjen e pasurive, drejtovnjë strategjinë e lëshimit dhe risigurimit drejt qëllimeve të përbashkëta të Byrosë, dhe specifikojnë kërkesat e raportimit.

Korniza rregullative

Aktiviteti i Byrosë është gjithashtu subjekt ndaj kërkesave rregullative përbrenda juridikzionit ku operon. Këto rregullore jo vetëm që përshkruajnë aprovin e monitorimin e aktiviteteve, por gjithashtu vënë disa dispozita frenuese për të minimizuar riskun e mos pagesave dhe insolvencës në anën e Byrosë së sigurimeve për t'u ballafaquar me detyrimet e paparashikuara që mund të lindin.

Risku i sigurimit

Risku kryesor që Byroja ballafaqohet nën kontratat e sigurimit është që dëmet e tanishme dhe pagesat e fitimeve ose koordinimi prej kësaj ndryshon nga çka është pritur. Kjo është e ndikuar nga frekuenca e dëmeve, ashpërsia e dëmeve, fitimet aktuale të paguara dhe zhvillimi pasues në dëme afatgjata. Për këtë arsyе objekti i Byrosë është të sigurojë që rezerva të mjaftueshme janë në dispozicion të mbulojnë këto detyrime.

Ekspozimi i mësipërm është zbutur nga shumëllojshmëria dhe madhësia e portfolios së kontratave të sigurimit dhe sipërfacja gjeografike. Ndryshueshmëria e riskut gjithashtu është përmirësuar nga një zgjedhje e kujdeshshme dhe implementimi i strategjisë me udhëzime të shkruara, gjithashtu edhe përdorimi i marrëveshjeve të risigurimit.

Shumica e bizneseve të sigurimit të licencuara janë themeluar në bazë të marrëveshjeve mbi humbjet e tejkaluara. Shumat e rikuperueshme nga risiguruesit janë illogaritur në mënyrë konsistente me provisionet e dëmeve të pazgjidhura dhe janë në pajtueshmëri me kontratat e risigurimit. Edhe pse Byroja ka marrëveshje të risigurimit, nuk është e liruar nga obligimet e saj direkte ndaj të siguruarve dhe për këtë arsyë ekziston ekspozimi i kreditit në lidhje me sigurimin e lëshuar, deri në masë që çdo risigurues nuk mund ti përmbush obligimet e supozuara në pajtueshmëri me risigurime të tillë.

**Byroja Kosovare e Sigurimit
Shënimet mbi pasqyrat financiare
Për vitin që ka përfunduar më 31 dhjetor 2021**

4 MENAXHIMI I RISKUT (VAZHDIM)

Analiza e maturitetit

Tabelat më poshtë organizojnë pasuritë dhe detyrimet financiare të Byrosë më 31 dhjetor 2021 dhe 2020 në grupime relevante sipas maturitetit të bazuar në periudhën e mbetur nga data e Pasqyrës së pozicionit financier deri në datën e maturimit si vijon:

31 dhjetor 2021	Deri në 6 muaj	6-12 muaj	Mbi 1 vit	Gjithsej
Pasuritë financiare				
Paraja dhe ekuivalentet e saj	3,116	-	-	3,116
Të arkëtueshmet	3,234	-	-	3,234
Të arkëtueshme nga kompanitë e sigurimeve për rezerva teknike	14,519	-	-	14,519
Gjithsej pasuritë financiare	20,869	-	-	20,869

Detyrimet financiare

Detyrimet e sigurimit për humbjet dhe shpenzimet e rregullimeve të humbjeve	14,348			14,348
Detyrimet e qirasë	18	18	29	65
Detyrimet tjera	4,671	-	-	4,671
Të pagueshmet të kompanitë e sigurimit për tepricat e akumuluara	1,213	-	-	1,213
Gjithsej detyrimet financiare	20,250	18	29	20,297
Hapësira e maturitetit	619	(18)	(29)	572

31 dhjetor 2020

	Deri në 6 muaj	6-12 muaj	Mbi 1 vit	Gjithsej
Pasuritë financiare				
Paraja dhe ekuivalentet e saj	1,831	-	-	1,831
Të arkëtueshmet	2,449	-	-	2,449
Të arkëtueshme nga kompanitë e sigurimeve për rezerva teknike	18,210	-	-	18,210
Gjithsej pasuritë financiare	22,490	-	-	22,490

Detyrimet financiare

Detyrimet e sigurimit për humbjet dhe shpenzimet e rregullimeve të humbjeve	18,210	-	-	18,210
Detyrimet e qirasë	28	15	-	43
Detyrimet tjera	3,554	-	-	3,554
Të pagueshmet të kompanitë e sigurimit për tepricat e akumuluara	470	-	-	470
Gjithsej detyrimet financiare	22,262	15	-	22,277
Hapësira e maturitetit	229	(15)	-	213

**Byroja Kosovare e Sigurimit
Shënimet mbi pasqyrat financiare
Për vitin që ka përfunduar më 31 dhjetor 2021**

4 MENAXHIMI I RISKUT (VAZHDIM)

Risku kreditor

Risku kreditor është rishku i humbjes financiare të Byrosë nëse një klient apo palë tjetër e instrumenteve financiare dështon në përbushjen e obligimeve kontraktuale, dhe del kryesish në të arkëtueshmet e Byrosë nga Byroja e Shqipërisë dhe Maqedonisë dhe parasë dhe ekvivalentet e parasë.

Byroja është e eksposuar ndaj riskut kreditor për pagesat e bëra të siguruesve bazuar në marrëveshjen me Byrotë në Shqipërisë dhe Maqedoni, sipas së cilës Byroja regjistron të arkëtueshmet nga Byroja përkatëse. Byroja ka politika që kufizojnë sasinë e ekspozimit kreditor ndaj ndonjë palë të kundërt. Ekspozimi maksimal i Byrosë ndaj riskut kreditor është përfaqësuar nga shuma bartëse e çdo pasurie financiar në pasqyrën e pozicionit.

	2021	2020
<i>Klasifikimet e pasurive financiare - vlerat bartëse</i>		
Paraja dhe ekvivalentet e parasë	3,116	1,831
Të arkëtueshmet	<u>3,234</u>	<u>2,449</u>
Gjithsej	<u>6,350</u>	<u>4,280</u>

Risku kreditor për paranë dhe ekvivalentet e parasë konsiderohet i ulët, pasi që palët janë banka me reputacion.

Risku i normës së interesit

Risku i normës së interesit është i përbërë nga risku që vlera e një instrumenti financiar do të luhatet për shkak të ndryshimeve në normat e interesit të tregut dhe rezikut që maturimi i pasurive që bartin interes të ndryshojë nga maturimi i detyrimeve të përdorura që bartin interes për të financuar këto pasuri. Gjatësia e kohës për të cilën norma e interesit është fiksë në një instrument financiar, pra tregon deri në çfarë mase kjo është e eksposuar ndaj rezikut të normës së interesit. Të ardhurat e Byrosë dhe rrjedha e parasë operative janë në thelb të pavarur nga ndryshimet në normat e interesit të tregut.

Më 31 dhjetor 2021 dhe 2020 të gjitha pasuritë dhe detyrimet financiare nuk bartin interes.

Risku nga kursi i këmbimit

Byroja nuk është e eksposuar ndaj riksut nga kursi i këmbimit meqenëse të gjitha transaksionet e saj janë kryer në valutën vendore.

**Byroja Kosovare e Sigurimit
Shënimet mbi pasqyrat financiare
Për vitin që ka përfunduar më 31 dhjetor 2021**

5 VLERËSIMI I VLERËS SË DREJTË

Vlera e drejtë paraqet shumën e cila do të pranohej nëse shitet një pasuri ose shuma që paguhet për të transferuar një detyrim në një transaksion të rregullt në mes të pjesëmarrësve të tregut në datën e matjes. Vlerat e drejta janë bazuar në supozimet menaxheriale sipas llojit të pasurive dhe detyrimit.

Instrumentet financiare të matura me vlerën e drejtë

Pasuritë financiare të matura sipas vlerës së drejtë në Pasqyrën e pozicionit finansiar janë paraqitur në përpunhje me hierarkinë e vlerës së drejtë. Kjo hierarki grupon pasuritë dhe detyrimet financiare në tri nivele që janë në bazë të një rëndësie nga të dhënat hyrëse të përdorura gjatë matjes së vlerës së drejtë të pasurive financiare:

- Niveli 1: çmimet e kuotuara (jo të rregulluara) në tregjet aktive për pasuritë dhe detyrimet identike;
- Niveli 2 : të dhënat tjera hyrëse, përvèç çmimeve të kuotuara, të përfshira në Nivelin 1 të cilat janë në dispozicion për vëzhgimin e pasurive ose detyrimeve, direkt (d.m.th. si çmimet), ose në mënyrë të tërthortë (d.m.th. të bëra nga çmimet) dhe
- Niveli 3 : të dhënat hyrëse mbi pasuritë ose detyrimet që nuk janë të bazuara në të dhënat e disponueshme për vëzhgimin e tregut.

Deri në datën e raportimit, Byroja nuk ka instrumente financiare të matura me vlerën e drejtë.

Instrumentet financiare që nuk janë prezantuara në vlerë të drejtë

Tabela në vijim përmblehdh shumat bartëse dhe vlerat e drejta për ato pasuri dhe detyrime financiare që nuk janë paraqitur në Pasqyrën e pozicionit finansiar në vlerën e tyre të drejtë (mijë euro).

	Shënimi	Vlera bartëse	Vlera e drejtë
31 dhjetor 2021			
Pasuritë financiare			
Paraja dhe ekuivalentët e parasë	11	3,116	3,116
Të arkëtueshmet	12	3,234	3,234
Të arkëtueshmet nga kompanitë e sigurimit për rezerva teknike	17	14,348	14,348
		20,698	20,698
Detyrimet financiare			
Detyrimet e sigurimit për humbjet dhe shpenzimet e rregullimit të humbjeve	18	14,348	14,348
Detyrimet e qirasë		65	65
Detyrime të tjera	20	4,671	4,671
Të pagueshmet tek kompanitë e sigurimeve për tepricat e grumbulluara	20	1,213	1,213
		20,297	20,297
31 dhjetor 2020			
Pasuritë financiare			
Paraja dhe ekuivalentet e parasë	11	1,831	1,831
Të arkëtueshmet	12	2,449	2,449
Të arkëtueshmet nga kompanitë e sigurimit për rezerva teknike	17	18,210	18,210
		22,490	22,490
Detyrimet financiare			
Detyrimet e sigurimit për humbjet dhe shpenzimet e rregullimit të humbjeve	18	18,210	18,210
Detyrimet e qirasë		43	43
Detyrime të tjera	20	3,554	3,554
Të pagueshmet tek kompanitë e sigurimeve për tepricat e grumbulluara	20	470	470
		22,277	22,277

**Byroja Kosovare e Sigurimit
Shënimet mbi pasqyrat financiare
Për vitin që ka përfunduar më 31 dhjetor 2021**

5 VLERËSIMI I VLERËS SË DREJTË (VAZHDIM)

Kreditë dhe të arkëtueshmet

Kreditë dhe të arkëtueshmet barten në koston e amortizimit, minus provisionet për zhvlerësim. Vlera e tyre e drejtë i përgjigjet vlerës së tyre bartëse, shkaku i maturitetit të tyre të shkurtër.

Pasuritë tjera financiare

Vlera e drejtë e pasurive monetare që përfshinë paranë dhe ekuivalentet e parasë konsiderohet t'i afrohet vlerës së tyre bartëse për shkak të maturitetit të tyre prej më pak se 3 muaj.

Detyrimet tjera

Vlera bartëse e detyrimeve tjera i afrohet vlerës së tyre bartëse për shkak të maturitetit të tyre prej më pak se 3 muaj.

**Byroja Kosovare e Sigurimit
Shënimet mbi pasqyrat financiare
Për vitin që ka përfunduar më 31 dhjetor 2021**

6 TË HYRAT NGA PRIMET E SIGURIMEVE

Të hyrat nga primet e sigurimeve, të cilat për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2021 janë në vlerë prej 8,578 mijë Euro (2020: 4,972 mijë Euro) ndërlihidhen me sigurimin e detyrueshëm për automjete motorike të palës së tretë në kufijtë e territorit të Kosovës për shoferët e automjeteve me regjistrome të huaja që nuk posedojnë një sigurim të tillë. Byroja është e autorizuar të mbledh këto të hyra në emër të të gjitha kompanive të sigurimit të licencuara nga Banka Qendore e Kosovës ("BQK") për të shitura polica të sigurimit përbrenda territorit të Kosovës. Bazuar në vendimin e marrë nga Banka Qendore e Kosovës të datës 18 korrik 2015 primet e sigurimit kufitar janë ulur dhe tarifat e reja janë të vlefshme nga 1 korrik 2015.

Marrëveshja ndërmjet BKS, MF, BQK dhe MPB parashikoi që para se të paguhet primi për policat e sigurimit të lëshuara sipas kësaj marrëveshje, të verifikohet në lidhje me hyrjen e automjeteve në kufijtë e Kosovës, nga Policia Kufitare. Duke pasur parasysh që për disa mjete motorike janë lëshuar polica të sigurimit si rinosimi i tyre, pasi blerjet në internet, blerjet në selinë e BKS në Prishtinë dhe në vendkalime të ndryshme kufitare (ku dalja nga territori i Kosovës nuk kërkohet për kontraktimin e sigurimeve), për këto kategorë verifikimi i politikave përkatëse nga Policia e Kosovës ende paraqitet si një pengesë, për të cilën ne jemi në komunikim të vazhdueshëm me MPB dhe MF për të gjetur zgjidhjen më të mirë për mbledhjen e fondeve.

BKS i ka dërguar një kërkësë zyrtare Thesarit të Shtetit në MF, kërkesa është adresuar në mbledhjen e Qeverisë së Kosovës dhe fondet përkatëse në vlerë prej 87 mijë euro janë të rezervuara, dhe apo të përfundojë procesi i verifikimit, do të krijohen kushtet për mbledhjen e tyre.

Në pajtim me ligjin për përgjegjësi të sigurimit të detyrueshëm të auto përgjegjësisë dhe vendimeve të Këshillit Administrativ, të ardhurat nga primi i sigurimit alokohen si vijon:

- Kontributi për fondin e kartonit të gjelbër në normën 20% gjatë vitit 2012
- Kontributi ne dëmet e fondit të kompensimit dhe BKS-së
- Kontributi për shpenzimet administrative të BKS-së
- dhe balanca e mbetur shpërndahet tek kompanitë e sigurimit

7 PRIMET E CEDUARA TEK RISIGURUESIT

Për vitet e përfunduara më 31 dhjetor 2021 dhe 2020, primet e transferuara tek risiguruesit janë në vlerë prej 53 mijë Euro dhe 70 mijë Euro, respektivisht.

Gjatë vitit të përfunduar më 31 dhjetor 2014 Byroja ka hyrë në një marrëveshje risigurimi me SIA Mai Reinsurance Brokers për tejkalin të humbjes së risigurimit për detyrime të palëve të treta motorike vendore. Kjo marrëveshje do të mbulojë fondin e kompensimit për shoferë të pasiguruar dhe politikat e detyrimeve të palëve të treta motorike transit.

8 TË HYRAT TJERA

	Për vitin që ka përfunduar më 31 dhjetor 2021 (në 000 Euro)	Për vitin që ka përfunduar më 31 dhjetor 2020 (në 000 Euro)
Të ardhura nga kompanitë e sigurimit për kontributet shtesë	5,649	3,651
Të ardhura nga organizata të shërbimeve të dëmeve	1,226	831
Të ardhura nga kompanitë e sigurimit për shpenzime operative dhe administrative	5,446	4,054
Efekti neto i barazimit të BKS-së me kompanitë e sigurimit	715	-
Të ardhura nga trajnimet	18	-
Gjithsej	13,056	8,536

Të ardhurat nga kompanitë e sigurimeve për kontributet shtesë

Gjatë vitit 2016, Byroja ka filluar implementimin e kërkësave për financimin e Fondit të kompensimit sipas nenit 32 paragrafi 2 të ligjit Nr. 04/L-018 si dhe nenit 4 të Regullores për Fondin e Kompensimit të Byrosë Kosovare të Sigurimeve. Bazuar në ligj, kërkohet që secili i siguruar në fillim të kuartalit të tretë duhet të depozitojë në llogarinë e Fondit të Kompensimit shumën e përcaktuar sipas rregullores. Gjithsej shuma e njohur për vitin e përfunduar me 2021 është 5,649 mijë euro (2020: 3,651 mijë euro).

Të ardhurat nga organizatat për shërbimin e dëmeve

Të ardhurat nga organizatat për shërbimin e dëmeve përfaqësojnë të ardhura nga Byroja nga palët tjera në Shqipëri, Maqedoni, Serbi dhe Mal të Zi.

Të ardhurat nga kompanitë e sigurimit për shpenzime operative dhe administrative

Të ardhurat nga kompanitë e sigurimit për shpenzime operative dhe administrative përfaqësojnë të ardhura për mbulimin e shpenzimeve operative dhe administrative të BKS-së. Të ardhurat për mbulimin e shpenzimeve operative dhe administrative më 31 dhjetor 2021 janë 5,446 mijë euro (2020: 4,054 mijë euro).

**Byroja Kosovare e Sigurimit
Shënimet mbi pasqyrat financiare
Për vitin që ka përfunduar më 31 dhjetor 2021**

8 TË HYRAT TJERA (VAZHDIM)

Efekti neto i barazimit të BKS-së me kompanitë e sigurimit

Gjatë vitit 2021, BKS-ja dhe kompanitë e sigurimeve kanë ndërmarrur veprime për rakordimin e balancave që rjedhin nga të ardhurat e sigurimeve kufitare dhe të fondit të kompensimit.

Ky proces ka sjellë efekt në balancat BKS-së. Prandaj, të arkëtueshmet nga sigurimet kufitare dhe fondi i kompensimit ishin më të larta se shuma e regjistruar në vitet e kaluara.

Më 31 dhjetor 2021, efekti neto nga rakordimi arrin në 715 mijë euro në total.

9 KOSTOT E PËRVETËSIMIT

	Për vitin që ka përfunduar më 31 dhjetor 2021 (në 000 Euro)	Për vitin që ka përfunduar më 31 dhjetor 2020 (në 000 Euro)
Primet për kompanitë e sigurimit	8,559	4,924
Teprica e vtit	743	652
Shpenzimet e personelit	553	682
Primet e rimbursuara tek kompanitë e sigurimit	20	22
Shpenzimet e printimit	30	21
Shpenzimet e qirasë	13	6
Kostoja e shtyrë e përvetësimit– DAC	60	-
Gjithsej	9,978	6,307

10 SHPENZIMET ADMINISTRATIVE

	Për vitin që ka përfunduar më 31 dhjetor 2021 (në 000 Euro)	Për vitin që ka përfunduar më 31 dhjetor 2020 (në 000 Euro)
Shpenzimet e personelit	522	579
Shpenzimet e zhvlerësimit dhe amortizimit(Shënimet 13,14,15)	84	88
Karburant dhe elektricitet	69	41
Mirëmbajtje	66	49
Furnizuesit e zyrës dhe shërbimet	55	36
Udhëtim dhe transport	37	10
Shpenzimet për garanci bankare	36	18
Shpenzimet e TI	34	-
Tarifat e bankës	22	20
Telefoni dhe Interneti	21	24
Shpenzimet e marketingut	18	1
Shpenzimet e trajnimit	16	-
Shpenzimet e përfaqësimit	15	3
Shpenzimet e interesit	3	5
Shpenzimet e fondeve nga regresi tek Kompanitë e Sigurimeve	-	115
Shpenzimet e qirasë	-	11
Provizioni i të arkëtueshmeve nga CSO Albania	-	-
Shpenzime tjera	24	23
Gjithsej	1,022	1,023

Byroja Kosovare e Sigurimit
Shënimet mbi pasqyrat financiare
Për vitin që ka përfunduar më 31 dhjetor 2021

11 PARAJA DHE EKUIVALENTËT E PARASË

	Për vitin që ka përfunduar më 31 dhjetor 2021 (në 000 Euro)	Për vitin që ka përfunduar më 31 dhjetor 2020 (në 000 Euro)
Paraja në bankë	235	297
Paraja e gatshme	32	34
	266	331
 Mjetet e blokuara për garancinë	 2,850	 1,500
Gjithsej	3,116	1,831

Mjetet e blokuara paraqesin mjetet e transferuara në llogari të blokuara që kanë të bëjnë me memorandumin e nënshkruar në mes të Byrosë dhe Shoqatës së Sigurimeve të Serbisë.

Gjithashtu, gjatë vitit 2021, BKS nënshkroi memorandum mirëkuptimi me Byronë Kombëtare të Sigurimeve të Republikës së Malit të Zi për njohjen e certifikatave TPL. Për këto veprime kërkohej një depozitim i garancisë kesh e cila është 1,350 mijë euro më 31 dhjetor 2021.

12 TË ARKËTUESHMET

	Për vitin që ka përfunduar më 31 dhjetor 2021 (në 000 Euro)	Për vitin që ka përfunduar më 31 dhjetor 2020 (në 000 Euro)
Të arkëtueshme nga kompanitë e sigurimit	1,634	1,710
Të arkëtueshme nga CSO - Shqipëria	1,825	1,775
Të arkëtueshme nga CSO - Maqedonia	87	2
Të arkëtueshme nga CSO - Serbia	78	-
Të arkëtueshme nga CSO - Mali i Zi	2	-
Minus: Provizioni nga dëmtimet e llogarive tjera të arkëtueshme –		
Shqipëria	(1,556)	(1,556)
	2,070	1,931
 Të arkëtueshme të tjera	 1,251	 627
Parapagimet	22	-
Minus: Provizioni nga dëmtimet e llogarive tjera të arkëtueshme	(109)	(109)
Të arkëtueshmet neto	3,234	2,449

Të arkëtueshmet nga kompanitë e sigurimit përfshijnë shumat nga kompanitë e sigurimeve. Për këto të arkëtueshme është një Marrëveshje ndërmjet BKS, MF, BQK dhe MPB parashikoi që para se të paguhet primi për policat e sigurimit të lëshuara sipas kësaj marrëveshje, të verifikohet në lidhje me hyrjen e automjeteve në kufijtë e Kosovës, nga Policia Kufitare. Duke pasur parasysh që për disa mjete motorike janë lëshuar polica të sigurimit si rinvimi i tyre, pasi blerjet në internet, blerjet në selinë e BKS-së në Prishtinë dhe në vendkalime të ndryshme kufitare (ku dalja nga territori i Kosovës nuk kërkohet për kontraktimin e sigurimeve), për këto kategori verifikimi i politikave përkatëse nga Policia e Kosovës ende paraqitet si një pengesë, për të cilën ne jemi në komunikim të vazhdueshëm me MPB dhe MF për të gjetur zgjidhjen më të mirë për mbledhjen e fondeve. BKS i ka dërguar një kërkesë zyrtare Thesarit të Shtetit në MF, kërkesa është adresuar në mbledhjen e Qeverisë së Kosovës dhe fondet përkatëse në vlerë prej 87 mijë euro janë të rezervuara, dhe sapo të përfundojë procesi i verifikimit, do të krijuan kushtet për mbledhjen e tyre orari i ri i pagesave i rënë dakord midis Byrosë dhe kompanive të sigurimit. Menaxhmenti është i arsyeshëm i sigurt se shuma të tilla do të rikuperohen plotësisht në të ardhmen, prandaj asnjë pasqyrë për këto të arkëtueshme nuk është njohur në pasqyrat financiare.

Byroja Kosovare e Sigurimit
Shënimet mbi pasqyrat financiare
Për vitin që ka përfunduar më 31 dhjetor 2021

				Përmirësimet në objektet me qira (në 000 Euro)	Gjithsej (në 000 Euro)
	Pajiset (në 000 Euro)	Mobiljet (në 000 Euro)	Automjetet (në 000 Euro)		
Kosto historike					
1 janar 2020	247	34	265	82	628
Shitesat gjatë vitit	4	-	12	25	41
31 dhjetor 2020	251	34	277	107	669
Shitesat gjatë vitit	16	27	0	-	43
31 dhjetor 2021	267	61	277	107	712
Zhvlerësimi i akumuluar					
1 janar 2020	247	26	249	72	595
Zhvlerësimi i vitit	4	-	12	2	18
31 dhjetor 2020	251	26	261	74	613
Zhvlerësimi i vitit	4	2	7	5	18
31 dhjetor 2021	255	28	268	79	631
Vlera neto					
31 dhjetor 2021	12	33	9	28	81
31 dhjetor 2020	-	8	16	33	56

BKS nuk ka pronë të lënë pëng më 31 dhjetor 2021 dhe të gjitha pasuritë janë përdorur për aktivitetet operuese të Byrosë.

**Byroja Kosovare e Sigurimit
Shënimet mbi pasqyrat financiare
Për vitin që ka përfunduar më 31 dhjetor 2021**

14 PASURITË E MARRA ME QIRA

Pasuritë me të drejtë përdorimi dhe detyrimet e qirasë

Byroja posedon me qira zyret qendore dhe disa qira afatshkurtra të ndryshme. Kontratat e qirasë zakonisht bëhen për periudha fikse nga 1 vit deri në 5 vite, por mund të kenë mundësi zgjatjeje siç përshkruhet më poshtë.

14.1 Pasuria me të drejtë përdorimi

	<i>Gjithsej (në 000 Euro)</i>
Kostoja	
Më 1 janar 2020	192
Shtesat gjatë vitit	-
Shlyerjet	-
Më 31 dhjetor 2020	192
Shtesat gjatë vitit	73
Më 31 dhjetor 2021	265
 Zhvlerësimi i akumuluar:	
Më 1 janar 2020	69
Shpenzimi për vitin	69
Shlyerjet	-
Më 31 dhjetor 2020	138
Shpenzimi për vitin	62
Shlyerjet	-
Më 31 dhjetor 2021	200
 Vlera neto në libra:	
Më 31 dhjetor 2020	54
Më 31 dhjetor 2021	65

14.2 Detyrimi i qirasë

	<i>Më 31 dhjetor 2021 (në 000 Euro)</i>	<i>Më 31 dhjetor 2020 (në 000 Euro)</i>
Më 1 janar	43	98
Kontrata e re	73	0
-minus pagesat e qirasë	(54)	(60)
Interesi në detyrimet e qirasë	3	5
Më 31 dhjetor	65	43

Byroja Kosovare e Sigurimit
Shënimet mbi pasqyrat financiare
Për vitin që ka përfunduar më 31 dhjetor 2021

15 PASURITË E PAPREKSHME

Kosto	Softuer dhe Licenca (në 000 Euro)	Gjithsej (në 000 Euro)
1 janar 2020	140	140
Shtesat gjatë vitit	27	27
31 dhjetor 2020	167	167
 Shtesat gjatë vitit	 -	 -
31 dhjetor 2021	167	167
 Amortizimi i akumuluar		
1 janar 2020	136	136
Amortizimi i vitit	-	-
31 dhjetor 2020	136	136
 Amortizimi i vitit	 4	 4
31 dhjetor 2021	140	140
 Vlera neto		
31 dhjetor 2021	27	27
31 dhjetor 2020	31	31

**Byroja Kosovare e Sigurimit
Shënimet mbi pasqyrat financiare
Për vitin që ka përfunduar më 31 dhjetor 2021**

16 KOSTO E SHTYRË E PËRVETËSIMIT

Më 31 dhjetor 2021 kosto e shtyrë e përvetësimit (DAC) ka qenë në shumën prej zero euro (2020:60 mijë Euro). Nga viti 2014 kalkulimi i kostos së shtyrë të përvetësimit bëhet duke u bazuar në udhëzimin administrativ të BQK me nr. 01/2014. Sipas udhëzimit, shpenzimet e lejuara për kalkulim janë shpenzimet e personelit për shitje të primeve. Pasi që BQK nuk ka obligim ndaj dy kategorive të mësipërme, DAC i kalkuluar për vitin 2020 paraqet vetëm pjesën e pa amortizuar të shpenzimeve të personelit për shitjet e primeve.

	2021 (në 000 Euro)	2020 (në 000 Euro)
Shpenzimet e personelit	-	60
Gjithsej	-	60

17 TË ARKËTUESHMET NGA KOMPANITË E SIGURIMIT PËR REZERVAT TEKNIKE

	31 dhjetor 2021 (në 000 Euro)	31 dhjetor 2020 (në 000 Euro)
Fondi i Kompenzimit	8,015	9,920
Sigurimi kufitar	6,210	8,119
Gjithsej	14,225	18,039

Të arkëtueshmet nga kompanitë e sigurimit përfshijnë shumat nga kompanitë e sigurimeve për dëmet e vlerësuara në të ardhmen (RBNS dhe IBNR). Për këto të arkëtueshme nuk ka orar të ri pagese të rënë dakord ndërmjet Byrosë dhe kompanive të sigurimit. Menaxhmenti është i sigurt në mënyrë të arsyeshme që shumat e tilla do të mbulohen plotësisht në të ardhmen. Prandaj nuk është njojur ndonjë lejim për këto të arkëtueshme në pasqyrat financiare.

18 DETYRIMET E SIGURIMIT PËR HUMBJE DHE SHPENZIMET E RREGULLIMIT TË HUMBJEVE

	Më 31 dhjetor 2021 (në 000 Euro)	Më 31 dhjetor 2020 (në 000 Euro)
Detyrimet bruto të sigurimit për humbje dhe shpenzime të përmirësimit të humbjeve 1 janar	18,039	17,075
Humbjet dhe shpenzimet e rregullimit të humbjeve të ndodhura gjatë vitit	6,606	7,206
Humbjet dhe shpenzimet e rregullimit të humbjeve të paguara gjatë vitit	(10,420)	(6,242)
Gjithsej	14,225	18,039

Byroja Kosovare e Sigurimit
Shënimet mbi pasqyrat financiare
Për vitin që ka përfunduar më 31 dhjetor 2021

19 REZERVAT E PRIMIT TË PAFITUAR

Ndryshimi në primin e pafituar është si në vijim:

	Më 31 dhjetor 2021	Më 31 dhjetor 2020
	(në 000 Euro)	(në 000 Euro)
Primet e pafituar më 1 janar	413	547
Primi sigurimit kufitar i pafituar më 31 dhjetor	(574)	(413)
Gjithsej	(161)	134

20 DETYRIME TË TJERA

	Më 31 dhjetor 2021	Më 31 dhjetor 2020
	(në 000 Euro)	(në 000 Euro)
Të pagueshmet ndaj kompanive të sigurimit	2,976	2,371
Të pagueshmet ndaj kompanive të sigurimit :Depozitat në Bankë – EMOU Serbia dhe Mali i Zi	2,850	1,500
Detyrimet ndaj Ministrisë së Financave	32	87
Shërbimet e sigurimit	26	67
Të pagueshmet e tjera ndaj kompanive të sigurimit	109	109
Minus: Provizioni për të pagueshmet e tjera (shënnimi 12)	(109)	(109)
Gjithsej	5,884	4,024

Të pagueshmet e tjera ndaj kompanive të sigurimit më 31 dhjetor 2021 dhe 2020 në vlerë prej 109 mijë Euro paraqesin paranë e vjedhur në një nga pikat e shitjes së Byrosë dhe zyrën kryesore gjatë viteve paraprake.

21 KONTINGJENCAT DHE ZOTIMET

Çështje gjyqësore

Byroja është e përfshirë në pretendime të ndryshme që lidhen me biznesin e saj të sigurimit. Më 31 dhjetor 2021, ka një numër të lartë të çështjeve gjyqësore për të cilat raste, në bazë të menaxhimit dhe të vlerësimin më të mirë të departamentit ligjor, byroja ka njojur provizionet të dëmeve të pazgjidhura – Të raportuara por jo të rregulluara. Më 31 dhjetor 2021, procedurat ligjore të ngritura kundër Byrosë nga kompanitë e sigurimeve, punonjësit dhe ish-punonjësit kapin shumën totale prej 2,794 mijë euro. Sipas menaxhmentit dhe mbrojtësit e tyre ligjor, rezultati përfundimtar i çështjes në datën e raportimit nuk mund të përcaktohet me ndonjë besueshmëri.

Detyrimet e tatimit

Për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2021, 2020, 2019, 2018, 2017, 2016, 2015, 2014, 2013 dhe 2012 libri i taksave të Byrosë dhe regjistimet nuk janë inspektuar nga autoritetet tatimore lokale. Byroja ka ndjekur rregullat dhe rregulloret gjatë llogaritjes së detyrimeve tatimore, sidoqoftë, interpretimet tatimore për autoritetet tatimore mund të ndryshojnë nga ato të përdorura nga Byroja.

Zotimet kapitale

Nuk ka zotime të rëndësishme kapitale më 31 dhjetor 2021 dhe 2020 që nuk janë njojur (në qoftë se ka) në pasqyrat financiare.

**Byroja Kosovare e Sigurimit
Shënimet mbi pasqyrat financiare
Për vitin që ka përfunduar më 31 dhjetor 2021**

22 TRANSAKSIONET ME PALËT E NDËRLIDHURA

Transaksionet me palët e ndërlidhura

Byroja ka transaksione të palëve të ndërlidhura me të gjitha kompanitë e sigurimit gjatë aktiviteteve në rrjedhën normale të biznesit. Të gjitha këto transaksione janë bartur në afate dhe kushte komerciale dhe me çmime të tregut. Tabela më poshtë tregon volumin dhe balancat nga transaksionet e palëve të ndërlidhura më dhe për vitin që përfundoi me 31 dhjetor 2021 dhe 2020:

31 dhjetor 2021

	Pasuritë	Detyrimet	Të hyrat	Shpenzimet
Menaxhmenti i lartë	-	-	-	61
Shpenzimet	-	-	-	30
Llogaria rrjedhëse	85			-
Gjithsej	85	-	-	91

31 dhjetor 2020

	Pasuritë	Detyrimet	Të hyrat	Shpenzimet
Menaxhmenti i lartë	-	-	-	76
Shpenzimet	-	-	-	21
Llogaria rrjedhëse	134			-
Gjithsej	134	-	-	97

23 NGJARJET PAS DATËS RAPORTUESE

Pas datës së raportimit, nuk ka rregullime të tjera që reflektojnë pasqyrat financiare ose ngjarje të tjera të rëndësishme që janë materiale për t'u shpalosur në këto pasqyra financiare.

BYROJA KOSOVARE E SIGURIMIT

RAPORT AUDITIMI AKTUARISTIK

Për përllogaritjen e rezervave teknike me datë 31 Dhjetor 2021

BYROJA KOSOVARE E SIGURIMIT - RAPORT I AKTUARIT

Përbledhje

1.	QËLLIMI DHE BAZA E AUDITIMIT	3
2.	GJETJET E AUDITIMIT.....	4
2.1	Rezervat për primin e pa fituar	4
2.2	Rezerva e dëmeve.....	5
2.2.1	Rezerva për dëme të ndodhura dhe të raportuara - RBNS	5
2.2.2	Rezerva për dëme të ndodhura por të paraportuara - IBNR.....	6
2.2.3	Rezerva në risigurim.....	7
2.2.4	Rezerva për shpenzime të trajtimit të dëmeve	7
3.	MENDIMI AKTUARISTIK	8

BYROJA KOSOVARE E SIGURIMIT - RAPORT I AKTUARIT

1. **QËLLIMI DHE BAZA E AUDITIMIT**

Nga ana e kompanisë së auditimit Grant Thornton L.L.C. me seli në Rr. Rexhep Mala Nr. 18, Prishtinë, Republika e Kosovës, jam angazhuar si ekspert i jashtëm aktuar i licencuar, për të bërë auditim të punës së Byrosë Kosovare të Sigurimit në këto lëmi:

- Auditim i pavarur i përllogaritjes së rezervave teknike të Byrosë me datë 31 Dhjetor 2021, edhe atë:

- Rezervave për primin e pa fituar (Unearned Premium Reserve - UPR)
- Rezervave për dëmet e ndodhura dhe raportuara (RBNS – Reported But Not Settled)
- Rezervave për dëmet e ndodhura por të pa raportuara (IBNR – Incurred But Not yet Reported)
- Rezervave tjera që ndan Kompania për mbarëvajtje të punës, me qëllim që të mund të mbulojë obligimet që dalin nga lidhja e kontratave të sigurimit

- Kontrollim i metodave të përdorura për llogaritje të rezervave

- Kontrollimi i rezervave është bërë për:

- Fondin e Kompenzimit (RBNS dhe rezerva për trajtimin e dëmeve)
- Sigurimin Kufitar (UPR, RBNS, IBNR dhe rezervat për trajtimin e dëmeve)

Për këtë qëllim si bazë janë marrë të dhëna relevante, që i kam kërkuar dhe më janë siguruar nga ana e Byrosë. Paralelisht më janë siguruar dhe kam shqyrtuar raportet e aktuarit përfundim e kompenzimit dhe sigurimin kufitar.

Të dhënat e kërkuara dhe siguruara kanë qenë të mjaftueshme që të mund të jep mendim relevant në lidhje me qëllimet e lartpërmendura.

BYROJA KOSOVARE E SIGURIMIT - RAPORT I AKTUARIT

2. GJETJET E AUDITIMIT

2.1 Rezervat për primin e pa fituar

Auditimi i rezervave për primin e pa fituar dhe rrezikun e pa skaduar është bërë në bazë të dhënave që janë ofruar nga Byroja, e që përmbajnë të gjitha elementet e duhura për të bërë auditim të plotë të këtyre rezervave. Të dhënat janë siguruar për çdo polisë aktive veçmas, me qëllim që të mund të bëhet kontrolli i llogaritjes në nivel të polisës.

Byroja mban rezerva për prim të pa fituar (UPR) vetëm për Sigurimet Kufitare.

Byroja bën llogaritjen e rezervës për prim të pa fituar sipas metodës Pro Rata Temporis, d.m.th. në përpjeshëtim të drejtë me kohën e mbetur të policës, edhe atë për çdo policë veçmas. Kjo metodë është në përputhje të plotë me praktikën botërore aktuaristike, si dhe me Rregulloren për vlerësim dhe mbajtje të provizioneve teknike dhe matematike për siguruesit jetë dhe jo-jetë.

Kam kontrolluar databazën e shitjes për vitin 2021 dhe formulat e përdorura për të llogaritur rezervën e primit të pa fituar. Mund të konstatoj se Byroja i ka llogaritur rezervat për prim të pa fituar – UPR në mënyrë adekuate.

Niveli total i rezervave UPR është 573.600 Euro. Shpërndarja ëshë bërë në mënyrë të drejtë në mes gjithë kompanive të sigurimeve jo-jetë.

BYROJA KOSOVARE E SIGURIMIT - RAPORT I AKTUARIT

2.2 Rezerva e dëmeve

Byroja ka llogaritur rezerva për dëmet e raportuara (RBNS), të ndodhura por të pa raportuara (IBNR) dhe rezerva për shpenzime të trajtimit të dëmeve. Rezerva për dëme të raportuara dhe për shpenzime trajtimi mbahen për Fondin e Kompenzimit dhe për Sigurimet Kufitare, ndërsa rezerva IBNR vetëm për Sigurimet Kufitare. Byroja gjithashtu ka llogaritur dhe shpërndarë rezerva për portfolion e trashëguar nga INSIG.

Për të bërë auditim më janë siguruar të dhëna relevante që përbajnjë të gjitha elementet e duhura për të kryer auditim të plotë të këtyre rezervave.

Më poshtë është tabela e të gjitha rezervave të Byrosë, për të gjitha llojet:

	Sigurimet Kufitare	Fondi i Kompenzimit	INSIG	Total
UPR	573.600		119.634	693.234
RBNS	3.711.710	7.743.207		11.454.917
IBNR	2.288.679			2.288.679
Rezerva për trajtim	210.014	271.012	3.888	484.914
Total	6.784.003	8.014.219	123.522	14.921.744

2.2.1 Rezerva për dëme të ndodhura dhe të raportuara - RBNS

Auditimi i këtyre rezervave është bërë nga lista e dëmeve të paraqitura, por akoma të pa likuiduara nga ana e kompanisë. Byroja mban rezerva për secilin dëm veçmas, duke u nisur nga përvaja paraprake dhe vlerësimi i ekspertëve rast për rasti. Kjo lloj llogaritje është adekuate dhe në përputhje me metodat e pranuara aktuaristike, ndërsa përgjegjësinë për secilën rezervë veçmas e mban Byroja dhe kompanitë anëtare të saj. Sidoqoftë aktuari mund të kompensojë mungesat eventuale gjatë përllogaritjes së IBNR, pjesa IBNER (Incurred But Not Enough Reserved). Mendimi jonë është se këto rezerva duhet pranuar ashtu siç janë, ndërsa mungesa eventuale mund të llogaritet dhe regjistrohet gjatë llogaritjes së IBNR.

Byroja poashtu mban rezervë RBNS për pjesën e dëmeve të trashëguara nga INSIG. Vlera totale e këtyre dëmeve është 119.634 Euro.

Dëmet nga fondi i kompensimit, sigurimi kufitar dhe ata nga INSIG janë shpërndarë në mënyrë adekuate nëpër Kompanitë e Sigurimit Jo-Jetë.

BYROJA KOSOVARE E SIGURIMIT - RAPORT I AKTUARIT

2.2.2 Rezerva për dëme të ndodhura por të paraportuara - IBNR

Byroja llogarit rezerva IBNR vetëm për Sigurimet Kufitare. Për të testuar mjaftueshmërinë e rezervave kam shqyrtuar kalkulimet e aktuarit, listën analitike të secilit dëm të paraqitur ku shihen datat e aksidentit dhe paraqitjes së dëmit, vitet e pagesës dhe rezervat aktuale për dëme të grumbulluara sipas viti të aksidentit.

Byroja ka llogaritur rezervat IBNR në dy mënyra:

- 1 – Me trekëndësha të zhvillimit të numrit të dëmeve dhe duke aplikuar një vlerë mesatare për këto dëme
- 2 – Me trekëndësha të dëmeve të paguara

Vlera e metodës me trekëndësha të dëmeve të paguara ka rezultuar më e lartë dhe kjo është vlera që është pranuar dhe regjistruar.

Metoda është aplikuar mbi dëmet e ndodhura nga viti 2006 e këtej, periudhë mëse e mjaftueshme për të parë trendet e zhvillimit të dëmeve. Ndërkohë dëmet janë zhvilluar deri në vitin e dhjetë të pagesës.

Nga zhvillimi i trekëndëshave janë fituar vlera përfaktorët e zhvillimit, të cilat më pas janë aplikuar për të fituar vlera Ultimate për secilin vit. Tail-factor nuk është përdorur.

Përfundimisht nga vlerat e fituara Ultimate janë zbritur dëmet e paguara dhe ato në rezervë RBNS dhe vlera e mbetur është regjistruar si IBNR. IBNR është llogaritur për secilin vit aksidenti veçmas, ndërsa vitet ku IBNR ka rezultuar negativ janë marrur si 0.

Në përjashtim prej kësaj mënyre të llogaritjes, për vitin 2021 vlera e fituar ultimate ka rezultuar shumë e lartë, për shkak se niveli i dëmeve të paguara brenda vitit 2021 është shumë më i lartë se vitet paraprake. Me këtë arsy, vlera ultimate për vitin 2021 është marrur si 30% e bruto primit të fituar.

Mendimi ynë

Metoda e përdorur është adekuate dhe është aplikuar në mënyrë të saktë. Është bërë kontroll i formulave dhe është konstatuar se ato janë aplikuar siç duhet.

I vetmi veprim jashtë trekëndëshave është korigjimi i rezultatit për vitin 2021, siç është cekur më sipër. Është bërë një testim paralel vetëm për këtë vit, duke supozuar sikur ky vit do të ndiqte trendet e mëparshme. Së pari është kontrolluar përqindja e paguar në vitin e parë dhe vërtetë përqindja është 11,1%, ndërsa mesatarja e viteve paraprake 6,8%, që vërteton supozimin se dëmet janë paguar më shpejtë. Duke përdorur mesataren 6,8% si pikënisje, kemi ardhur në konstatim se sikur 2021 të ndiqte trendet e mëparshme, atëherë koeficienti për këtë vit do të rezultonte 23,2%. Duke qenë se është përdorur koeficient 30%, veprimi i Byrosë është i arsyeshëm.

Sidoqoftë do të rekomandojmë që zhvillimi i mëtejshëm i dëmeve të vitit 2021 të ndiqet me kujdes, nëse eventualisht është rezultati i ndonjë fenomeni tjetër dhe jo i pagesës së përshtypuar të dëmeve.

IBNR e llogaritur për sigurimet kufitare është shpërndarë në mënyrë të drejtë mes kompanive të sigurimit.

BYROJA KOSOVARE E SIGURIMIT - RAPORT I AKTUARIT

2.2.3 Rezerva në risigurim

Nuk ka

2.2.4 Rezerva për shpenzime të trajtimit të dëmeve

Si pjesë e rezervave teknike për dëme Byroja ruan edhe rezerva për shpenzime për trajtim të dëmeve. Duke u nisur nga përvoja paraprake Byroja i llogarit këto rezerva si 3,5% të shumës së RBNS për Fondin e Kompenzimit dhe 3,5% të shumës së RBNS dhe IBNR për Sigurimet Kufitare, nivel që është i arsyeshëm sipas praktikës aktuaristike. Pra mund të konstatojmë se këto rezerva janë në nivel të duhur.

BYROJA KOSOVARE E SIGURIMIT - RAPORT I AKTUARIT

3. MENDIMI AKTUARISTIK

Nga Auditimi i pavarur aktuaristik i metodave dhe llogariljeve të rezervave teknike të Byrosë Kosovare të Sigurimeve me gjendjen në datë 31.12.2021, konstatoj se Byroja i llogarit rezervat në përputhje me praktikën dhe standartet e pranuara aktuaristike dhe Rregulloren për vlerësim dhe mbajtje të provizioneve teknike dhe matematike për siguruesit jetë dhe jo-jetë.

Konstatimi vlen për të gjitha llojet e rezervave të llogaritura, njëkohësisht për Fondin e Kompenzimit dhe Sigurimet Kufitare.

Ky konstatim është bazuar mbi përpunimin e të dhënavë që më janë siguruar nga Byroja, e që kanë përmblajtur të gjitha elementet e nevojshme për të dhënë mendim përfundimtar mbi nivelin e rezervave teknike.

21 Prill 2022

vv

Aktuar i licencuar

Tetovë

Robert Nesimi

